

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5397
E enjte, 8 shkurt 2018
çmimi 0.40 €

Çitaku kërkon nga Serbia t'i zbatojë marrëveshjet e Brukselit

Ambasadorja e Kosovës në ShBA, Vlora Çitaku, gjatë raportimit në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, ka bërë thirrje që Serbia t'i zbatojë marrëveshjet e arritura me Kosovën në Bruksel ■ FAQE 2



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



FLET PËR "EPOKËN E RE", ENVER HOXHAJ ■ FAQE 4-5

Strategjia e BE-së e obligon Serbinë ta njohë Kosovën



Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka bërë me dije se me strategjinë e re të zgjerimit të BE-së, Serbia obligohet ta njohë Republikën e Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ky dokument, përveçse e sheh

Kosovën pjesë të politikës së zgjerimit të BE-së, ofron edhe një qartësi të procesit të dialogut me Serbinë. Hoxhaj ka treguar për ndikimin që kanë pasur në këtë dokument pesë vendet anëtare të BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën. Ai i ka ftuar anëtarët

e BE-së që kanë njohur Kosovën të mos fshihen pas zërave kundërshtues, por të jenë të qartë për të ardhmen evropiane të Kosovës. Hoxhaj ka bërë thirrje të gjendet një zgjidhje e shpejtë konsensuale për demarkacionin me Malin e Zi

AKTUALE

**ENERGJIA, NDOTËSI
KRYESOR I AJRIT** F. 3

**EMËROHEN ANËTARËT E RINJ
NË KËSHILLIN DREJTUES TË
UP-së** F. 6

**GJAKOVA MERR MBËSHTETJE
TË FUQISHME NGA QEVERIA** F. 11

EKONOMI

**BORDI I KOSTT-it MORI PAGA
DHE SHITESA NË MËNYRË TË
KUNDËRLIGJSHME** F. 9

**INTERKONJEKSIONI
KOSOVË - SHQIPËRI, I
BLLOKUAR NGA SERBIA QË
NJË VIT E GJYSMË** F. 8

KULTURË

**HISTORIA DHE
KUJTESA
POPULLORE** F. 18



Prof. dr. Nusret
PLLANA

SPORT

**SALIHU: BESA NUK REFUZOHET,
MBIJETESA NUK DISKUTOHET** F. 18

**ORARI I GARAVE TË
ALBIN TAHIRIT NË LOD
'PYEONGCHANG 2018'** F. 18

KMDLNj-ja ngre shqetësime se Gjykata Speciale mund të korruptohet

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka bërë me dije se gjykatësit dhe prokurorët e korruptuar të UNMIK-ut dhe të EULEX-it do ta

korruptojnë edhe Gjykatën Speciale. KMDLNj-ja ka vlerësuar se faktori ndërkombëtar e ka politizuar dhe deprofesionalizuar sistemin vendor të drejtësisë ■ FAQE 3



Rama: FSK-ja është e gatshme për transformim në Forca të Armatosura

■ FAQE 6

RENOVA
Mazeboni
Xhëgjajt-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROLKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob: +377(0) 44 506 815
Toll-Free: +381(0) 29 246 810
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara ka diskutuar për situatën e fundit në Kosovë

Çitaku kërkon nga Serbia t'i zbatojë marrëveshjet e Brukselit

Ambasadorja e Kosovës në ShBA, Vlora Çitaku, gjatë raportimit të saj në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, ka bërë thirrje që Serbia t'i zbatojë marrëveshjet e arritura me Kosovën në Bruksel

"Epoka e re"

Nju Jork, 7 shkurt - Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ka diskutuar të mërkurën raportin e fundit të sekretarit të OKB-së, Antonio Guterres, mbi punën e UNMIK-ut në Kosovë për periudhën katërmujore.

Ambasadorja e Kosovës në ShBA, Vlora Çitaku, në fjalën e saj para anëtarëve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, ka thënë se sa më herët që Serbia e njeh Kosovën do të jetë më mirë për rajonin", ka thënë ajo, duke rikonfirmuar përkushtimin e Kosovës për dialogun e Brukselit.

Po ashtu, ambasadorja Çitaku ka deklaruar se një status quo e re nuk do t'i shërbejë normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Sot po takohemi një ditë pasi BE-ja publikoi strategjinë e zgjerimit të Ballkanit Perëndimor. Ajo që u tha qartë është se Kosova dhe Serbia duhet t'i normalizojnë marrëdhëniet dhe të kenë marrëveshje ligjore", ka thënë ambasadorja Çitaku.

Ajo ka thënë se marrëveshjet e Brukselit duhet të implementohen. "Siç e kam thënë shumë herë, ne në Kosovë besojmë se platforma dhe vendi i duhur për dialog është Brukseli. Dua ta riafirmoj angazhimin tonë ndaj dialogut në Bruksel dhe zbatimin e çdo marrëveshjeje të arritur atje", ka thënë Çitaku. Ajo ka shtuar se Kosova më 17 shkurt shënon dhjetëvjetorin e shtetësisë së saj. "Tani pas 10 vjetësh, Kosova është njohur nga një shumicë dërrmuese e vendeve të botës dhe është



anëtare e një numri të madh organizatash", ka thënë ambasadorja Çitaku, e cila ka falënderuar ShBA-në për mbështetjen që ia kanë dhënë Kosovës. "ShBA-ja ka qenë pranë nesh dhe në kohët tona më të errëta dhe për këtë do t'i jemi mirënjohës gjithmonë", ka pohuar ajo.

Çitaku në fjalimin e saj ka përmendur të arriturat e disa grave kosovare, të cilat, ndonjëse në kushte e rrethana të vështira, me aktivitetin e tyre e bënë krenar atë dhe të gjithë qytetarët e shtetit të Kosovës. Me këtë rast, ajo përmendi Majlinda Kelmendin, për të cilën tha se, megjithëse ushtri në sallë pa rrymë e pa ngrohje dhe refuzoi miliona mundësi, na bëri krenarë të gjithëve, duke fituar medaljen e artë. "Ajo e bëri këtë në emër të dashurisë për atdheun e saj, Republikën e Kosovës", ka theksuar ambasadorja.

Ambasadorja e Kosovës në ShBA, Vlora Çitaku, ka folur edhe për vrasjen e politikanit serb në veri, Oliver Ivanoviq. "Lidhur edhe me vrasjen fatkeqe të Oliver Ivanoviqit, pavarësisht çka ka ndodhur në të kaluarën, vrasja e tij nuk ka nxitur urrejtje etnike. Sikurse politikanët shqiptarë edhe ata

serbë janë pajtuar se krimi i organizuar duhet të fajsohet për këtë vrasje. Ne nuk do të lëmë gurë pa lëvizur derisa kryerësit e këtij krimi të dalin para drejtësisë", ka thënë Çitaku. Duke folur për Gjykatën Speciale, ambasadorja Çitaku ka thënë se asnjë gjykatë nuk mund ta rishkruajë historinë apo të imponojë moral. "Shtypësi dhe i shtypuri janë të definuar në historinë tonë", ka thënë ajo.

Daçiçi akuzon Prishtinën se nuk po i zbaton marrëveshjet e Brukselit

Ministri i Punëve të Jashtme i Serbisë, Ivica Daçiçi, ka kritikuar krerët shtetërorë të Kosovës pasi, sipas tij, Beogradi është në pritje tash e një kohë që Prishtina t'i kryejë obligimet e marrëveshjeve të arritura në Bruksel. "Serbia ende po pret me padurim që ShBA, Vlora Çitaku, ka folur edhe për vrasjen e politikanit serb në veri, Oliver Ivanoviq. "Lidhur edhe me vrasjen fatkeqe të Oliver Ivanoviqit, pavarësisht çka ka ndodhur në të kaluarën, vrasja e tij nuk ka nxitur urrejtje etnike. Sikurse politikanët shqiptarë edhe ata

në fjalimin e tij në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Ai ka folur edhe për vrasjen e Oliver Ivanoviqit. "Realiteti është se Oliver Ivanoviqi është vrarë dhe kjo ka rrezikuar gjendjen në atë zonë. Vrasja e Ivanoviqit është plotësisht një akt terrorist që rrezikon gjendjen në

Kosovë dhe në rajon", ka thënë Daçiçi.

Ministri i Jashtëm serb, Ivica Daçiçi, ka komentuar rastin e nismës së deputetëve të Kosovës për zhbërjen e Gjykatës Speciale, ndërsa ka potencuar se krimet nuk mund të mbeten të pandëshkuara.

Tanin kërkon vazhdimin e dialogut Kosovë - Serbi

Shefi i UNMIK-ut, Zahir Tanin, ka deklaruar sot se Strategjia e re e zgjerimit të Bashkimit Evropian ka dëshmuar se dialogu dhe normalizimi i marrëdhënieve të Beogradit e të Prishtinës janë parakushte për aspirimin e Kosovës për t'u bërë anëtare të BE-së. Tanin, i cili me videolink nga Prishtina u lidh me mbledhjen e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, ka vlerësuar se në Prishtinë ka mendime të ndryshme për strategjinë porse shumica liderëve e kanë theksuar rëndësinë e saj. Ai ka tërhequr vërejtjen pse nuk ka pasur

zhvillim dialogu tash e një vit ndërmjet Beogradit e Prishtinës. Tanin ka thënë se nuk janë zbatuar disa marrëveshje dhe këtu ai e ka përmendur asociacionin e komunave serbe. Ai nuk është pajtuar me përpjekjen për shfuqizimin e Speciales. Formimin e saj në vitin 2015 e ka quajtur arritje të madhe të Kosovës dhe ka kërkuar që Kosova t'i respektojë marrëveshjet ndërkombëtare. Në fund Tanin e ka dënuar vrasjen e Oliver Ivanoviqit, ka bërë thirrje për ruajtje të paqes dhe ka kërkuar të verifikohet identiteti i vrasësve të tij.

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka reaguar lidhur me rekrutimin e stafit gjyqësor dhe prokurorial për Gjykatën Speciale

KMDLNj ngre shqetësime se Gjykata Speciale mund të korruptohet

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka bërë me dije se gjykatësit dhe prokurorët e korruptuar të UNMIK-ut dhe të EULEX-it do ta korruptojnë edhe Gjykatën Speciale. KMDLNj-ja ka vlerësuar se faktori ndërkombëtar e ka politizuar dhe deprofesionalizuar sistemin vendor të drejtësisë

EPOKA ERE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 7 SHKURT - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) të mërkurën nëpërmjet një reagimi për medie ka paralajmëruar se gjykatësit dhe prokurorët e korruptuar të UNMIK-ut dhe EULEX-it do ta korruptojnë edhe Gjykatën Speciale. Sipas KMDLNj-së, këta mercenarë shëtitës do ta vazhdojnë orgjinë e korrupsionit edhe në Gjykatën Speciale. "Sa i përket rekrutimit të stafit gjyqësor dhe prokurorial për Gjykatën Speciale nga radhët e Tribunalit të Hagës, UNMIK-ut dhe EULEX-it, e që kanë dështuar në përbushjen e misionit, përveçse paraqet konflikt të interesit, është edhe një dukuri e vazhdimit të dhënies së mundësisë për korruptim të këtij stafi, siç ndodhi më parë, e që për pasojë do të ketë mungesë të drejtësisë për viktima si dhe amnistia për ata që planifikuan, urdhëruan, nuk penguan dhe bënë krime që sankcionohen si shkelje e ligjeve të luftës dhe të së Drejtës Humanitare. Gjykatësit dhe prokurorët e korruptuar të UNMIK-ut dhe të EULEX-it do

ta korruptojnë edhe Gjykatën Speciale. Këta mercenarë shëtitës të ripunësuar në kundërshtim me çdo moral njerëzor dhe ligjeve pozitive, do ta vazhdojnë orgjinë e korrupsionit edhe në Gjykatën Speciale për shkak të përfitimeve të mëdha materiale, diktateve politike të të pushtetshëmve si dhe avancimit të tyre në karrierë", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Në vazhdim të këtij reagimi është theksuar se këtyre, sikur edhe disa politikanëve kosovarë, nuk u intereson drejtësia për viktima dhe dënimi i kriminelëve, por u intereson xhironlogaria dhe ruajtja e lëkurës. "Si në kohën e Tribunalit të Hagës, misioneve të kriminalizuara të UNMIK-ut dhe EULEX-it e deri te misioni, pa asnjë dyshim i dështuar, (me qëllim dhe i planifikuar) i Gjykatës Speciale e cila është një vazhdimësi e ndikimeve politike sikur tek ato të tjerat. Do të ishte befasi e shkëlqyer nëse ndodh e kundërta!", është thënë në reagimin e KMDLNj-së. KMDLNj ka vlerësuar se faktori ndërkombëtar e ka politizuar dhe deprofesionalizuar sistemin e drejtësisë në Kosovë. Sipas KMDLNj-së, misionet



ndërkombëtare në Kosovë nuk e kanë pasur për qëllim sigurimin e drejtësisë për viktima e as ndarjen e përgjegjësisë për ata që kanë bërë krime, por përmes proceseve të kurdisura u kanë shërbyer proceseve politike. "Këto misione kanë shqyrtuar rastet më të rënda si ato të krimeve të luftës, krimet të organizuar të nivelit të lartë, korrupsionit të 'peshqve të mëdhenj', trafikimit të qenieve njerëzore si dhe konflikteve me motive etnike dhe politike. Nëse bëhet një përmbledhje e rezultateve në këto fusha, del se janë fare modeste apo nuk ka

rezultate hiç. Mospuna, mosuksesi, dështimi apo mosdashja e përbushjes së misionit të UNMIK-ut dhe EULEX-it është adresuar si përgjegjësi e autoriteteve vendore që jo se janë pyetur për diçka, por janë injoruar skajsh-mërisht. Po të punonte si duhej Tribunali i Hagës, UNMIK-ut dhe EULEX-i, nuk do të kishte fare nevojë për themelimin e Gjykatës Speciale ku gjojnë strehë dhe punë të dështuarit e Tribunalit të Hagës, ata të UNMIK-ut dhe të EULEX-it dhe aventurierë të tjerë që drejtësinë e marrin dhe e përdorin si

mundësi për mbushje të xhironlogarive dhe dhunim të drejtësisë", është theksuar në reagimin e KMDLNj-së. Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut ka rikujtuar se vetëm pasi ta kenë përfunduar mandatin apo janë larguar nga puna, prokurorë dhe gjykatës të Tribunalit të Hagës, UNMIK-ut dhe EULEX-it kanë folur për dështimet, proceset e kurdisura për eliminime politike, korrupsion marramendës të këtij personeli e që pikërisht nga këto misione është dashur të hetohen, gjykohehen dhe dënohen.

Energjia, ndotësi kryesor i ajrit

PRISHTINË, 7 SHKURT - Të mërkurën në Prishtinë është mbajtur forumi i parë profesional akademik me temën "Çështjet urbane mjedisore, ndotja e ajrit në Prishtinë dhe më gjerë", që është organizuar nga Fakulteti i Inxhinierisë Ndërtimore e Infrastrukturu dhe Fakulteti i Energjisë Eficiente në kuadër të UBT-së. Panelistë të këtij forumi ishin përfaqësues të shoqërisë civile dhe ekspertë të fushës përkatëse. Në këtë forum është diskutuar për cilësinë e ajrit dhe çështjet ambientale në Kosovë, me ç'rast rektori i UBT-së, Edmond Hajrizi, ka thënë këto probleme datojnë qysh vite më parë. "Në UBT punojnë mbi 200 doktorë shkence të cilët mund të ndihmojnë dhe japin konkluzione për planifikimin urban dhe hartimin e strategjive edukate", ka thënë

Hajrizi, duke treguar se ka kuadro që gjenerojnë dije, por mungojnë trupat e certifikimit që bëjnë certifikimin e personave për energji dhe ambient. Duke folur për faktorët që ndikojnë në cilësinë e ajrit, ligjëruesja në UBT, Pranvera Dobruna-Kryeziu, ka theksuar se energjia është ndotësi kryesor i ajrit në Kosovë. Ajo ka thënë se duhet të aplikohen politika proaktive, në mënyrë që të ketë përmirësim në cilësi të ajrit. "Kosova e Re është politikë që në masë të madhe do të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së ajrit. Të gjitha aktivitetet që zhvillohen gjithnjë shkojnë për përmirësimin e gjendjes, përfshirë edhe aktivitetet e UBT-së, ku si institucion do të jetë aktive me konferenca dhe forume ku marrin pjesë ekspertë të fushave përkatëse", ka deklaruar Dobruna-Kryeziu.



Flet për "Epokën e re", Enver Hoxhaj

Strategjia e BE-së e obligon

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka bërë me dije se me strategjinë e re të zgjerimit të BE-së, Serbia obligohet ta njohë Republikën e Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ky dokument, përveçse e shihet Kosovën pjesë të politikës së zgjerimit të BE-së, ofron edhe një qartësi të procesit të dialogut me Serbinë. Hoxhaj ka treguar për ndikimin që kanë pasur në këtë dokument pesë vendet anëtare të BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën. Ai i ka ftuar anëtarët e BE-së që e kanë njohur Kosovën të mos fshihen pas zërave kundërshtues, por të jenë të qartë për të ardhmen evropiane të Kosovës. Hoxhaj ka bërë thirrje që të gjendet një zgjidhje e shpejtë konsensuale për demarkacionin me Malin e Zi

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 7 SHKURT - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, e ka vlerësuar shumë pozitive strategjinë e re të zgjerimit të Bashkimit Evropian (BE) për vendet e Ballkanit Perëndimor. Ai ka bërë me dije se ky dokument, përveçse e shihet Kosovën pjesë të politikës së zgjerimit të BE-së, ofron edhe një qartësi të procesit të dialogut me Serbinë.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hoxhaj ka thënë se kjo strategji obligon Serbinë të bëjë një marrëveshje obligative me Kosovën, e cila është njohje e ndërsjellë ndërmjet dy vendeve. "Kjo strategji ka edhe një dimension të dytë kur është fjala e normalizimit të raporteve Kosovë - Serbi, ofron një qartësi të plotë që dialogu për normalizim duhet të përfundojë me arritjen e një marrëveshje obligative ligjore e cila për Kosovën, për anëtarët e BE-së dhe për vetë BE-në, nuk është gjë tjetër vetëm njohje e ndërsjellë ndërmjet dy vendeve", ka thënë Hoxhaj.

Duke përmendur aspektet jo të favorshme të strategjisë për Kosovën, ai ka thënë se Serbia nga të gjitha vendet e tjera të rajonit është favorizuar kësaj radhe. "Nëse shohim për pjesët që nuk i pëlqejnë dhe nuk duhet t'i pëlqejnë Prishtinës, dhe në këtë drejtim Prishtina nuk duhet të jetë as super entuziaste, apo edhe naive, ka të bëjë me faktin se nuk ofrohet një qartësi kohore, një plan kohor se kur mund të lëvizë Kosova drejt një stadi të ri të raportit kontraktual me BE-në. Me fjalë të tjera, ne kemi pritur që do ta marrim statusin e kandidatit", ka thënë Hoxhaj, duke shtuar se ndikim në këtë dokument kanë pasur edhe pesë vendet anëtare të BE-së që nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës.

Zëvendëskryeministri Hoxhaj i ka ftuar vendet anëtare të BE-së të cilat e kanë njohur Kosovën, të mos fshihen pas zërave që kundërshtojnë, por ta tregojnë perspektivën e qartë për

Republikën e Kosovës.

Në këtë intervistë Hoxhaj ka folur edhe për obligimet që Kosova ka ndaj strategjisë së BE-së. Sipas tij, demarkacioni me Malin e Zi duhet të miratohet sa më shpejt. "Në pikëpamjen time individuale, qytetarët e Kosovës bëhen evropianë të mirëfilltë në atë moment kur ne miratojmë demarkacionin dhe kur ata lëvizin pa viza drejt Evropës. Kjo është çështja më e rëndësishme në politikën e Kosovës. Prandaj si Qeveri dhe si partnerë të koalicionit duhet ta gjejmë një zgjidhje konsensuale e cila do të duhet të votohej në Kuvendin e Kosovës", është shprehur Hoxhaj.

"Epoka e re": Z. Hoxhaj, Komisionit Evropian të martën ka prezantuar strategjinë e re të zgjerimit për vendet e Ballkanit Perëndimor. Cili është komentit juaj për këtë dokument?

Hoxhaj: Marrë në tërësi, kjo strategji ka elemente dhe dimensione shumë pozitive për Kosovën nëse kemi parasysh faktin se Republika e Kosovës është pjesë e politikës së zgjerimit. Pra, diçka që është e rëndësishme sa për Kosovën aq edhe për vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, por edhe për të ardhmen e BE-së. Në të njëjtën kohë kjo strategji ka edhe një dimension të dytë, kur është fjala e normalizimit të raporteve Kosovë - Serbi, pasi ofron një qartësi të plotë që dialogu për normalizim duhet të përfundojë me arritjen e një marrëveshje obligative ligjore e cila për Kosovën, për anëtarët e BE-së dhe për vetë BE-në, nuk është gjë tjetër vetëm njohje e ndërsjellë ndërmjet dy vendeve. Përtej dimensionit Kosovë - BE dhe Kosovë - Serbi është mirë që në një kohë të një vakumi gjeopolitik, në një kohë të sfidave dhe të kërcënimeve globale, në një kohë kur BE-ja po ballafaqohet me kriza të shumta të brendshme, qoftë politike, ekonomike, financiare, dhe të trendeve populiste të shumë qeverive brenda shteteve anëtare të BE-së, ka dalë me një dokument se si mund të duket e ardhmja e Ballkanit.

"Epoka e re": Megjithatë, ky dokument nuk ka arritur të paraqesë një perspektivë të anëtarësimit gjithëpërfshirës dhe të barabartë për të gjitha vendet e rajonit. Madje Kosovës nuk i ka ofruar qartësi për anëtarësim në BE?

Hoxhaj: Nëse shohim për pjesët që nuk i pëlqejnë dhe nuk duhet t'i pëlqejnë Prishtinës, dhe në këtë drejtim Prishtina nuk duhet të jetë as super entuziaste apo edhe naive, ka të bëjë me faktin se nuk ofrohet një qartësi kohore, një plan kohor se kur mund të lëvizë Kosova drejt një stadi të ri të raportit kontraktual me BE-në. Me fjalë të tjera, ne kemi pritur që do ta marrim statusin e kandidatit dhe ka një lloj favoriti të Serbisë, meqenëse asaj i ofrohet edhe një datë e anëtarësimit.

"Epoka e re": Pse mendoni se ka ndodhur ky mosqartësim i perspektivës së anëtarësimit të Kosovës në BE?

Hoxhaj: Ne duhet të jemi shumë realistë dhe mos ta krijojmë një kulturë vetëm të ushtrimit të kritikës mbi institucionet e BE-së. Natyrisht se BE-ja do të duhet dhe duhet ta ofrojë statusin e vendit kandidat për Kosovën, nëse vendeve të tjera ua ofron edhe datat për anëtarësim në BE. Kjo është më se e logjishme. Mendoj se edhe në raport me Shqipërinë dhe Maqedoninë, dokumenti nuk është i avancuar pasi më shumë e favorizon Serbinë. Përtej kësaj, Kosova është vendi i fundit që ka filluar ta zbatojë agjendën evropiane të integritimit nëse kemi parasysh kohën kur ka nënshkruar marrëveshjen e MSA-së. Ne kemi pasur një proces të shtetndërrimit i cili është i fundit në rajon. Po ashtu, jemi të fundit që kemi filluar raportet kontraktuale me BE-në. Por, edhe për shkak të faktit se dialogu Kosovë - Serbi është shpallur si një lloj instrumenti gjeopolitik, i cili do të duhet më shumë ta mbështet Serbinë për shkak të ndikimit rus dhe ta trajtojë Serbinë drejt një partneriteti me BE-në dhe me Perëndimin sesa të shihen duket e ardhmja e Ballkanit.

"Epoka e re": Është thënë se kjo qasje ndaj Kosovës është pasojë e mosnjohjes së Kosovës nga pesë shtetet anëtare të BE-së. Sa qëndron kjo?

Hoxhaj: Pajtohem me konstatimin tuaj. Institucionet e BE-së, presidenti Juncker, znj. Mogherini dhe komisionari Hahn kanë treguar vullnet dhe gatishmëri të plotë që ta mbështetin Kosovën në avancimin e raportit kontraktual me BE-në. Kjo vërehet edhe në dokument, por edhe në konferencën për medie ku Mogherini dhe Hahn ishin shumë të qartë. Ata që e njohin në thelb politikën e zgjerimit i njohin metodat dhe format se si shtyhet zgjerimi. E dinë se agjenda evropiane e Kosovës është diçka që jepet për vendet që priten ta marrin statusin e vendit kandidat. Faktikisht, BE-ja ka pasur

vullnet, por disa shtete anëtare kanë ngritur hezitime të ndryshme. Përtej asaj se cili shtet ka mundur ta reflektojë politikën individuale në raport me Kosovën, jam i mendimit se shumica e shteteve që e kanë njohur Kosovën si shtet sovran dhe të pavarur nuk do të duhet të fshihen pas flamurit kundërshtar të ndonjë shteti, por duhet të jenë të qarta në raport me të ardhmen e Kosovës. Qasja jonë si Kosovë, jo vetëm në raport me këtë strategji, por në këta 10 vjetët e pavarësisë, ka qenë promovimi i një politike dualiste. Sa të mbështesim forcimin e marrëdhënieve bilaterale mes shtetit të Kosovës dhe vendeve anëtare të BE-së, po aq edhe të krijojmë një raport të mirëfilltë kontraktual me institucionet e BE-së. Por, natyrisht se shtetet anëtare që nuk e kanë njohur

Serbinë ta njohë Kosovën



Kosovën e kanë pasur ndikimin e tyre në këtë strategji.

"Epoka e re": Cila është përgjegjësia e institucioneve të Kosovës në këtë drejtim? Jo rrallë institucionet janë kritikuar për moskryerjen e obligimeve që kanë marrë në raport me BE.

Hoxhaj: Politika e zgjerimit nuk është vetëm politike e jashtme. Ajo është edhe politike e brendshme. Zgjerimi ka të bëjë edhe me dinamikën e brendshme të shteteve të cilat aspirojnë të bëhen pjesë e familjeve evropiane. Në këtë drejtim, nëse BE-ja i ka grupuar shtetet e rajonit në tri shpejtësi të ndryshme, atëherë në shpejtësinë e parë e ka futur Malin e Zi dhe Serbinë, duke u ofruar vitin 2025 si vit të mundshëm të anëtarësimit, ndërsa në grupin e dytë, Maqedoninë dhe Shqipërinë. Duke konstatuar se

me këto dy vende mund të hapen negociatat për anëtarësim shumë shpejt, dhe në grupin e tretë Bosnjën dhe Kosovën. Nëse kjo është mënyra se si Komisioni Evropian e lexon rajonin, varet se cila është shpejtësia jonë e brendshme. Kjo shpejtësi varet prej reformave që i kryejmë brenda vendit. Qeveria e Kosovës ka prioritet zbatimin e Agjendës Evropiane të Reformës (ERA). Kryeministri Haradinaj ka zhvilluar disa takime dhe ka kërkuar nga ministrat ta bëjnë punën e tyre në këtë drejtim. Mirëpo, kjo nuk duhet të jetë vetëm një përkushtim yni deklarativ, por duhet të bëhen shumë punë. Kosova duhet t'i zbatojë 22 prioritetet që ka para vetes, qoftë punët që duhet t'i kryejë Kuvendi i Kosovës përmes miratimit të ligjeve të caktuara, qoftë punët që duhet t'i kryejë

Qeveria apo edhe punët që duhet t'i kryejnë partitë politike. Integrimi në BE është pasojë e zhvillimit ekonomik. Nëse nuk

arrijmë ta përmirësojmë gjendjen ekonomike dhe ta modernizojmë shoqërinë atëherë do ta kemi vështirë që të

jemi pjesë e familjes evropiane. Vetëm zhvillimi ekonomik dhe modernizimi krijonë parakushte që Kosova të jetë pjesë e BE-së.

"Epoka e re": Si do t'i qaset Qeveria e Kosovës kësaj strategjie?

Hoxhaj: Nuk ka vend as për dëshpërim e as për frustrim. Ne duhet të punojmë që gjatë vitit 2018 ta zbatojmë agjendën evropiane të reformave dhe ta dërgojmë aplikimin tonë për status të kandidatit, diçka që unë kam kërkuar që në vitin 2017. Kur ne të aplikojmë për status të kandidatit, që merr kohë derisa të trajtohet një temë e tillë, ne mund ta avancojmë pozitën e Kosovës në raport me BE-në, pavarësisht asaj që shkruhet apo nuk shkruhet në strategjinë e zgjerimit të Komisionit Evropian. Aty ku Kosova mund të bëjë progres është zbatimi i MSA-së. Pra, rruga e Kosovës është e hapur. Nëse kjo strategji është deri në vitin 2025, ne duhet të shikojmë se çfarë mund të bëjmë në shtatë vjetet e ardhshëm. Dinamika e integrimit për vendet e rajonit ka qenë e ndryshme. E mbaj mend kur Kroacia dhe Maqedonia në vitin 2001 kanë nënshkruar MSA-në dhe në vitin 2013 Kroacia është bërë shtet anëtar i BE-së, ndërsa Maqedonia ende në vitin 2018 nuk i ka hapur negociatat për anëtarësim. Pra, gjithçka varet prej dinamikës së brendshme të secilit shtet. Nëse e shohim hartën e rajonit, shihet se ka një garë në rajon se kush po lëviz më shpejt. Maqedonia po bën përpjekje t'i zgjidhë temat të cilat i ka të hapura me Greqinë, Shqipëria po bën përpjekje t'i zgjidhë temat të cilat i ka të hapura me Greqinë. Po ashtu, Serbia po bën përpjekje t'i zgjidhë temat e hapura me Kosovën përmes dialogut për normalizim të raporteve, kurse Mali i Zi po përkushtohet ndaj këtyre temave.

Duhet të gjejmë zgjidhje konsensuale për demarkacionin

"Epoka e re": Z. Hoxhaj, Kosova ka një çështje të hapur me Malin e Zi, që është demarkacioni. Me çfarë shpejtësie do të zgjidhet kjo çështje?

Hoxhaj: Në pikëpamjen time individuale qytetarët e Kosovës bëhen evropianë të mirëfilltë në atë moment kur e miratojmë demarkacionin dhe kur ata lëvizin pa viza drejt Evropës. Kjo është çështja më e rëndësishme në politiken e Kosovës. Prandaj, si Qeveri dhe si partner

të koalicionit duhet ta gjejmë një zgjidhje konsensuale e cila do të duhej të votohej në Kuvendin e Kosovës. Unë nuk jam për atë që ne të tregojmë vetëm përmes deklaratave se cilat janë qëndrimet tona, sepse dihen qëndrimet e secilit subjekt politik dhe pothuajse të secilit individ sa i përket kësaj teme. Duhet ta krijojmë një momentum dhe ta dërgojmë marrëveshjen dhe raportin e komisionit në Kuvendin e

Kosovës dhe ta gjejmë një zgjidhje që të ecim përpara. Nëse ju e keni dëgjuar me vëmendje deklaratën e Mogherinit, ka theksuar qartë se në atë moment kur përmes kriterit të demarkacionit, qytetarët e Kosovës lëvizin pa viza drejt Evropës. Mendoj se një deklaratë e tillë e thënë në Bruksel ka qenë lajmi më i fuqishëm që mund ta thotë dikush nga pozita që ka aktualisht Mogherini.

Rama: FSK-ja është e gatshme për transformim në Forca të Armatosura

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Rrahman Rama, gjatë raportimit në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, ka bërë me dije se FSK-ja është e gatshme për transformim në Forca të Armatosura

"Epoka e re"

PRISHTINË, 7 SHKURT - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralletënant Rrahman Rama, ka raportuar në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, lidhur me raportin vjetor të punës për vitin 2017. Fillimisht gjeneralletënant Rama, duke prezantuar këtë raport të vitit paraprak, ka sqaruar në detaje aktivitetet që FSK-ja ka pasur përgjatë vitit 2017, duke përmendur edhe pjesëmarrjen e tyre gjatë vërshimeve në Shqipëri. Ai ka folur

edhe për bashkëpunimin e FSK-së me ndërkombëtarët dhe për marrëveshjet e tyre bilaterale. Po ashtu, gjeneralletënant Rama ka folur edhe për projektet e tjera humanitare, për donacionet për FSK-në, rekrutimin e komuniteteve joshumicë në FSK, si dhe për sfidat me të cilat FSK-ja është ballafaquar në 2017-n.

Duke u përgjigjur në çështjet që u ngritën nga anëtarët të komisionit, komandanti i FSK-së, sa i përket transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura, Rama ka theksuar se janë të gatshëm t'i kryejnë detyrat dhe obligimin e tyre ligjor. "Qëllimi kryesor yni është të jemi në



shërbim të qytetarëve dhe t'u ofrojmë atyre siguri", është shprehur Rama, duke shtuar se FSK-ja është e gatshme në çdo

kohë për transformim të FSK-së në Forca të Armatosura, kurdo që të merret vendimi politik.

Anëtarët të komisionit gjatë diskutimit të tyre FSK-në e vlerësuan si institucionin më kredibil dhe më të besueshëm.

Nostrifikimi i diplomave me Serbinë, i ndikuar politikisht

PRISHTINË, 7 SHKURT (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka raportuar të mërkurën në mbledhjen e Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut për çështjen e nostrifikimit të diplomave të fituara në universitetet të Serbisë. Shkas për këtë mbledhje ka qenë një peticion i komunitetit boshnjak, të cilët nuk arrijnë të punësohen në Kosovë për shkak të mosnostrifikimit të diplomave, e që është obligim ligjor për punësim. Me këtë rast, ministri Bytyqi ka theksuar se në procesin e nostrifikimit ka pasur probleme edhe me shtete të tjera por, siç dihet, sa i përket nostrifikimit të diplomave të fituara, në Serbi ka implikime politike. Ministri Bytyqi ka sqaruar se gjatë bisedimeve në Bruksel janë arritur dy marrëveshje në këtë drejtim. Ai ka pohuar se



marrëveshja e parë e arritur në vitin 2011 ka dhënë rezultate në këtë drejtim, ku përmes

organizatës SPARK (e financuar nga BE), janë shqyrtuar një numër i madh i aplikacion-

eve. Ndërsa sa i përket marrëveshjes së dytë të vitit 2016, Bytyqi ka theksuar se ende nuk

është arritur ndonjë rezultat për shkaqe teknike dhe politike.

Ministri Bytyqi ka thënë se janë duke u ndërmarrë hapa në këtë drejtim dhe tashmë është caktuar një koordinator nga ana e Qeverisë dhe pritet edhe emërimi i një personi përgjegjës për nostrifikimin e këtyre diplomave.

Ministri Bytyqi iu përgjigj edhe pyetjeve të anëtarëve të komisionit rreth funksionimit të Qendrës NARIC, për të cilën tha se tashmë janë evidentuar problemet që kanë shkaktuar pritjet e gjata për nostrifikim të diplomave të fituara në vende të ndryshme dhe kanë filluar të merren masat për të vënë rregull. Gjatë këtij takimi është theksuar se në të njëjtën vështirësi ndodhen edhe shqiptarët që jetojnë në shtetin serb që kanë mbaruar studimet në Kosovë.

Emërohen anëtarët e rinj në Këshillin Drejtues të UP-së

PRISHTINË, 7 SHKURT (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka marrë vendim për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina". Anëtarët e rinj të Këshillit Drejtues të

UP "Hasan Prishtina", të emëruar me vendim të ministrit, janë: mr. Ardiana Bunjaku, mr. sc. Drita Shoshi, mr. sc. Laura Kryeziu, dr. sc. Fadil Osmani. "Me këtë vendim, MASHT-i ka dashur të rrisë 50 për qind të kuotës gjinore,

që na obligon Ligji për barazi gjinore, madje është tejkaluar kjo përqindje, e tani do të kemi rreth 70 për qind femra anëtare në Këshillin Drejtues të UP 'Hasan Prishtina' që emërohen me vendim të ministrit", është thënë në njoftimin e MASHT-it.



Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka mbajtur konferencë për medie

Hoxha: Kosova dhe Serbia, me rrugë të ndara drejt BE-së



"Kemi pritur më shumë dhe hapa më konkretë drejt procesit të integritimit në strategjinë e re të Bashkimit Evropian për vendet e Ballkanit Perëndimor. Megjithatë, integrimi i Kosovës në BE nuk ka alternativë", kështu ka deklaruar ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, e cila ka thënë se kjo strategji ka konfirmuar se Kosova dhe Serbia janë me rrugë të ndara drejt BE-së

LV-ja: Qasje e BE-së ndaj Ballkanit, sinjal i qartë për Kosovën dhe shqiptarët

Lëvizja Vetëvendosje (LV) nëpërmjet një komunikate për medie ka vlerësuar se strategjia e Komisionit Evropian për Ballkanin Perëndimor i vendos gjashtë vendet në një konkurrencë të pabarabartë me njëri-tjetrin, duke i mbyllur sytë para problemeve që ka shkaktuar e vazhdon t'i shkaktojë Serbia në rajon. Sipas LV-së, sa i takon Kosovës, strategjia e Komisionit jo vetëm se nuk jep orientim për datë anëtarësimi, apo për të qenë vend kandidat për anëtarësim, por nuk jep as edhe një sinjal që diçka e tillë do të jetë e mundshme. Kjo qasje e BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor, sipas Vetëvendosjes, është sinjal i qartë për Kosovën dhe shqiptarët në përgjithësi. "Në kategorinë e katërt dhe të fun-

dit, BE-ja ka vendosur Kosovën, duke përdorur fusnotën që vazhdon ta trajtojë me ambiguitet shpalljen e pavarësisë sonë. Kjo qasje e BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor është një sinjal shumë i qartë për Kosovën dhe shqiptarët në përgjithësi. Ne duhet ta ideojmë dhe strukturojmë një politikë të brendshme e rajonale, të Kosovës e të Shqipërisë, për ta vendosur peshën që kemi dhe për t'i realizuar qëllimet ku duam të jemi, në Ballkanin Perëndimor e drejt BE-së", është thënë në komunikatën e Vetëvendosjes. Megjithatë, sipas LV-së, propozimi për përfshirjen e shteteve të Ballkanit Perëndimor në komitetet teknike dhe grupet e punës së Komisionit Evropian është një hap pozitiv për gjithë rajonin.

EPOKA
ERE **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 7 SHKURT - Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, të mërkurën ka bërë me dije se ka pritur hapa më konkretë në strategjinë e re të Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor. Megjithatë, ajo ka thënë se Kosovës i mbetet t'i përfundojë obligimet në mënyrë që të ecë me hapa të shpejtë drejt BE-së sepse, sipas Hoxhës, integrimi i Kosovës në Bashkimin Evropian nuk ka alternativë. "Ne si Kosovë e mirëpresim strategjinë e Bashkimit Evropian për anëtarësimin e shteteve të Ballkanit

Perëndimor, pjesë e së cilës është edhe Kosova. Bashkimi Evropian na ka hapur derën dhe ne duhet të kalojmë në këtë derë. Në këtë fazë kemi pritur më shumë dhe hapa më konkretë drejt këtij procesi të integritimit por, megjithatë, integrimi ynë në BE nuk ka alternativë", ka deklaruar Hoxha në një konferencë për medie. Ministrja Hoxha ka thënë se Bashkimi Evropian në këtë strategji ka konfirmuar se Kosova dhe Serbia janë me rrugë të ndara drejt BE-së. "Fakti që Bashkimi Evropian e trajton procesin e aderimit të Kosovës në BE të ndarë nga Serbia thotë mjaft dhe për mua

është një njohje e shtetësisë së Kosovës përkundër mosnjohjes së disa shteteve anëtare të Bashkimit Evropian. Gjithashtu, është pozitive që BE-ja kërkon kategorikisht që Serbia dhe Bashkimi Evropian të arrijnë një marrëveshje juridike të detyrueshme si parakusht për anëtarësimin e tyre në BE. Kjo e detyron Serbinë t'i japë fund politikës së saj bllokuese ndaj Kosovës dhe të njohë edhe juridikisht realitetin politik që Kosova është shtet i pavarur", është shprehur Hoxha. Kurse presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, këtë strategji e ka vlerësuar si një përpjekje të

BE-së për ta rritur përkushtimin dhe nxitur reformat e shteteve të rajonit për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Por, sipas tij, kjo strategji ka dështuar të ofrojë qartësi për anëtarësimin e Kosovës në BE. "Megjithatë, për arsye të njohura politike, fatkeqësisht, ky dokument nuk ka arritur të paraqesë një perspektivë të anëtarësimi gjithëpërfshirës dhe të barabartë për të gjitha vendet e rajonit. Në veçanti, kjo strategji ka dështuar të ofrojë qartësi për anëtarësimin e Kosovës në BE. Kjo qasje jo e drejtë ndaj Kosovës është pasojë e mosnjohjes nga pesë shtete anëtare të BE-së, respektivisht e paafetësisë

së BE-së për një qëndrim unik për Kosovën. Por, Kosova nuk do të zhytet në dëshpërim", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka thënë se Kosova duhet ta shfrytëzojë potencialin e plotë të kësaj strategjie për ta avancuar pozicionin e saj në rrugën drejt anëtarësimi, për zbatimin e reformave të nevojshme evropiane dhe për ta përmbyllur procesin e dialogut me Serbinë. "Kosova urgjentisht duhet ta tejkalojë gjendjen e izolimit, duke ratifikuar marrëveshjen për vijën kufitare me Malin e Zi, e cila sjell edhe heqjen e vizave për qytetarët tanë nga BE-ja", ka theksuar Thaçi.

Togeri i FSK-së, Albert Asllani, shpallet kadeti më i mirë në ShBA

PRISHTINË, 7 SHKURT - Oficeri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), togeri Albert Asllani, pas një trajnimi gjashtëmujor në shkollën ushtarake "United States Army Cyber Center of Excellence" në Fort Gordon të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), u nderua me çmimin "Colonel Alan C. Dexter, OBE, Award". Këtë çmim e marrin studentët e dalluar të cilët tregojnë arritje të larta akademike si

dhe profesionalizëm dhe lidhship gjatë studimeve. Çmimi "Colonel Alan C. Dexter, OBE, Award" për Togeri Albert Asllanin është edhe një dëshmi se Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) është në rrugë të duhur sa i përket ngritjes profesionale të pjesëtarëve të saj dhe se ky kualitet profesional është duke u dëshmuar edhe jashtë vendit si në: shkollime, trajnime, operacione, përfshirë këto edhe në akademitë më prestigjioze në botë.

Togeri Albert Asllani, pas kthimit nga ShBA-ja, do ta vazhdojë shërbimin në Komandën e Forcave Tokësore (KFT) duke bartur përvojat e tij të fituara në këtë trajnim specialistik në të mirë të avancimit dhe ngritjes profesionale të FSK-së. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë oficerë nga shumë vende të botës. Ky është trajnim special për përgatitjen e oficerëve (kapiten) të karrierës.



Bordi i FMN-së për Kosovë mirëpret reformat e ndërmarra në sektorin e ekonomisë

PRISHTINË, 7 SHKURT (ER) - Bordi i FMN-së për Kosovë ka mirëpritur performancën e mirë ekonomike në vend dhe reformat që janë ndërmarrë, si dhe u ka bërë thirrje autoriteteve t'i përshpejtojnë edhe më shumë reformat strukturore. Këto komente kanë dalë nga përmbyllja e suksesshme e mbledhjes së bordit të FMN-së për Kosovë ku është diskutuar rreth raportit të stafit të FMN-së "Konsultimet e Artikullit IV me Kosovën". Po ashtu, pas vlerësimit të performancës, anëtarët e bordit të FMN-së e kanë aprovuar edhe kalimin e Kosovës nga artikulli XIV në artikullin VIII. "Sa i përket politikave fiskale, bordi u pajtua se politikat fiskale mbeten adekuate dhe se rregulla fiskale siguron ruajtjen e qëndrueshmërisë fiskale në vend. Duke u

ndërlidhur me sektorin financiar, bordi vuri në pah progresin e madh të arritur në sektorin financiar dhe e përshëndetën implementimin e rekomandimeve të Programit të Vlerësimit të Stabilitetit Financiar që është realizuar në vitin 2012. Bordi vlerësoi pozitivisht zhvillimet në sistemin financiar të Kosovës, ku theks i veçantë u vu mbi rritjen e kreditimit, përmirësimin e kornizës së mbikëqyrjes dhe rregullimit të sektorit financiar. Një vlerësim i përgjithshëm pozitiv u theksua edhe për përmirësimet e viteve të fundit në raportin e Bankës Botërore 'Doing Business', në të cilin Kosova ka avancuar në shumë fusha të rëndësishme për përmirësimin e ambientit afarisht, përfshirë edhe qasjen në financa", është thënë në njoftimin e BQK-së.



Beqaj: Me ndihmën e BB-së do të zhvillojmë programe për fuqizimin e të rinjve



Beqaj ka theksuar rëndësinë që ka bashkëpunimi i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë me Bankën Botërore në zhvillimin e programe të përbashkëta me qëllim të përkrahjes së të rinjve dhe grave, si dhe me qëllim të rritjes ekonomike të Kosovës dhe krijimin e mundësive për hapjen e vendeve të reja të punës.

Uashington, 7 shkurt (ER) - Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, në kuadër të vizitës dhe takimeve të shumta në ShBA, në zyrat qendrore të Bankës Botërore është takuar me Paulo Corrae, drejtor i Departamentit të Financave, Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, si dhe me Mario Guadamillas, drejtor i Departamentit për Konkurrueshmëri dhe Praktika Ndërkombëtare të Inovacionit. Pas këtij takimi ministri Beqaj ka thënë se Banka Botërore është e përkushtuar për të ofruar asistencë teknike për Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, duke shfrytëzuar kapacitetet dhe

përvojën e shumtë që ka në rajon dhe më gjerë. Beqaj ka theksuar rëndësinë që ka bashkëpunimi i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë me Bankën Botërore në zhvillimin e programe të përbashkëta me qëllim të përkrahjes së të rinjve dhe grave, si dhe me qëllim të rritjes ekonomike të Kosovës dhe krijimin e mundësive për hapjen e vendeve të reja të punës. "Gjithashtu, u akordua për zhvillimin e programeve të përbashkëta për fuqizimin e të rinjve, grave dhe sektorin privat në përgjithësi. Do të gjejmë mënyra për krijimin e fondeve të përbashkëta", ka deklaruar Beqaj.

Fetahu: Investitorët turq të interesuar të investojnë në Kosovë

PRISHTINË, 7 SHKURT (ER) - Zëvendësministri i Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Arian Daci, ka pritur të mërkurën në takim drejtorin ekzekutiv të Odës Tregtare Kosovare-Turke, Arben Fetahu. Me këtë rast, Fetahu ka shprehur interesimin e investi-

torëve potencialë strategjikë turq për të investuar në Kosovë, përkatësisht në sektorin e minierave dhe në dikastere të tjera të industrisë. Ai ka theksuar se Oda Tregtare Kosovare-Turke është urë lidhëse mes investitorëve turq dhe Kosovës. Në anën tjetër, zëvendësministri Daci e ka njoftuar

kryetarin Fetahu për lehtësitë që po i bën Qeveria e Kosovës, e në këtë kuadër edhe Ministria e Diasporës për investitorët e mundshëm strategjikë. Në këtë takim u bisedua edhe për lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mallrave ndërmjet dy vendeve mike si dhe për lehtësira të tjera në të bërit biznes.



Bordi i KOSTT-it mori paga dhe shtesa në mënyrë të kundërligjshme

Anëtarët e Bordit të Ndërmarrjes Publike Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) kanë marrë vendim t'ia ngritin pagën vetes në mënyrë të kundërligjshëm gjashtë muaj para se të merrej vendimi në Kuvendin e Kosovës. Anëtarët e Bordit të KOSTT-it nuk u ndalën me kaq, pasi e shpërblyen veten edhe me nga 90 euro për çdo mbledhje që kishin mbajtur. Ky vendim është kundërshtuar të mërkurën nga anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 7 SHKURT - Komisioni për Buxhet dhe Financa, i kryesuar nga deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të KOSTT-it, Projektligjin për infrastrukturën kritike, ndryshim-plotësimin e Ligjit për kufirin shtetëror, Projektligjin për shoqëritë tregtare etj. Në këtë komision raportin vjetor financiar i KOSTT-it është pritur me shqetësim si nga deputetët e pozitës, po ashtu dhe ata të opozitës për shkak të vendimeve të kundërligjshme që ka operuar ky institucion sa i përket rritjes së pagave për bordin pa bazë ligjore dhe, po ashtu, shumës prej 90 eurosh që bordi i KOSTT-it ka shpërblyer vetën kundërligjshëm për çdo mbledhje që ka mbajtur. Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Lumir Abdixhiku, ua ka përmendur përfaqësuesve të bordit të KOSTT-it vendimet antiligjore në bazë të të cilave kanë operuar. "Kuvendi kishte vendosur që pagat të rriteshin në dhjetor,

kurse bordi i drejtorëve të KOSTT-it ia ka rritur pagat vetes gjashtë muaj para se të merrej vendimi. Po ashtu, ia ka caktuar vetes nga 90 euro për çdo mbledhje që ka mbajtur. Pesë mbledhje në vit i ka mbajtur ky bord. Pra, pos pagave të majme, anëtarët kanë marrë edhe para për mbledhje", ka thënë Abdixhiku.

Kurse Gani Jashari, kryesues i drejtorëve të bordit të KOSTT-it, ka thënë se nga Qeveria e Kosovës janë shkarkuar tre anëtarë dhe, sipas tij, ky institucion nuk është në gjendje të mirë. I zëshëm në këtë drejtim ishte edhe deputeti i Nismës Socialdemokrate, Enver Hoti, i cili ka bërë me dije se para se të emërohen në këtë bord, anëtarët kanë përdorur ndikime të shumta. Sipas tij, anëtarët e bordit të KOSTT-it, pos që kanë paga të larta, ata marrin edhe shtesa për mbledhjet që kanë mbajtur. "Këta e kanë ditur se nuk kanë bazë ligjore për rritje të pagave dhe kanë intervenuar bajagi shumë kur kanë hyrë në punë", ka thënë Hoti. Ai ka kërkuar edhe zgjidhje për bllokimin e linjës së interkonjeksionit me Shqipërinë si dhe për kamatën e kredisë që



paguajnë qytetarët.

Edhe deputetja e PDK-së, Safete Hadergjonaj, ka dhënë kritika në drejtim të përfaqësuesve të KOSTT-it. "Vendimi është marrë me 7/12 dhe paga ka qenë bukur e mirë për një bord joekzekutiv. Pagaat janë

nga 1 350 euro deri në 1 550 euro dhe pos këtyre, janë marrë edhe shtesa prej 90 eurosh për mbledhjet që kanë mbajtur. E gjithë kjo është e kundërligjshme dhe shqetësuese. Gjithashtu, kemi pasur raste kur ndërmarrjet publike

kanë dalë në fitim, pastaj fitimin e kanë ndarë individët mes vete. Për këto paga dhe shtesa duhet të vendosë gjykatë, pastaj të shihet nëse ato mjete duhet t'i kthehen buxhetit të Kosovës", ka thënë Hadergjonaj.

Interkonjeksioni Kosovë - Shqipëri, i bllokuar nga Serbia që një vit e gjysmë



PRISHTINË, 7 SHKURT (ER) - Ushtruesi i detyrës së kryeshefit ekzekutiv i KOSTT-it, Kadri Kadriu, ka pritur të mërkurën në takim ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi. Në takim u diskutua rreth bashkëpunimit të frytshëm në sektorin e energjisë në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, progresit në krijimin e tregut të përbashkët të energjisë elektrike si dhe procesit të themelimit të bursës shqiptare të energjisë (APEX), ku Kosova përmes KOSTT-it do të jetë aksionare. "Në kuadër të takimit, në veçanti u diskutua rreth sfidave në drejtim të

fillimit të implementimit të marrëveshjes së kycjes KOSTT-ENTSO-E me të cilën është e ndërlidhur edhe vënia në operim e linjës së re interkonjeksive 400 kV Kosovë - Shqipëri, projekt kapital i cili u bashkëfinancua me qeverinë gjermane përmes Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW)", është bërë me dije në komunikatën e KOSTT-it. Ambasadori Minxhozi dhe ushtruesi i detyrës së kryeshefit ekzekutiv të KOSTT-it kanë shprehur shqetësimin e tyre për bllokimin e vënies në funksion të linjës 400 kV Kosovë - Shqipëri tashmë një vit e gjysmë nga inaugurimi i projektit.

Lutfi Haziri merr post të ri në Hagë

GJILAN, 7 SHKURT - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, është zgjedhur anëtar i Parlamentit Global të Kryetarëve (GPM) të komunave, me seli në Hagë, duke u bërë kështu kryetari i parë i ndonjë komune nga rajoni që përfaqësohet në këtë institucion. Në letërën e mirëseardhjes si anëtar i këtij institucioni drejtuar Lutfi Hazirit nga Patricia de Lile, kryetare e Komitetit Ekzekutiv të Parlamentit, njëherësh kryetare e Cape Town, është thënë se "puna dhe zëri i Hazirit në kuadër të GPM-së do të jetë esencial për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve në mes të qyteteve e

komunave ndërkombëtarisht në përgjithësi, por edhe në mes të rajonit të Ballkanit dhe GPM-së, në veçanti".

Ndërsa Haziri ka thënë se ndihet i nderuar që i është dhënë kjo mundësi dhe se ky është një privilegj dhe mirënjohje e veçantë që i bëhet edhe Gjilanit dhe Kosovës. Parlamenti Global i Kryetarëve të Komunave mbledh në vete kryetarë komunash nga të pesë kontinentet që për misionin ka ofrimin dhe shkëmbimin e përvojave dhe lidershit të kryetarëve të komunave në lidhje me ballafaqimin dhe zgjidhjen e sfidave të qeverisjes lokale që ndërlihen edhe me sfidat globale.



Klina e nis vitin mbarë në realizimin e të hyrave vetjake

KLINË, 7 SHKURT - Komuna e Klinës e ka nisur mirë vitin kalendarik në realizimin e të hyrave vetjake, të cilat kanë shënuar rritje për 64 për qind më shumë, krahasuar me të njëjtin periudhë të vitit të kaluar.

Drejtori i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, Aziz Desku, ka bërë me dije se Komuna e Klinës gjatë muajit janar 2018 ka realizuar të hyra vetjake në vlerë prej 64.847.66 eurosh nga llojet e ndryshme të të hyrave vetjake të adminis-

tratës komunale dhe 6.620.00 euro të hyra nga gjocat e trafikut.

Gjithsej të hyra në muajin e parë të vitit janë realizuar 71.467.66 euro. Të hyrat vetjake për të njëjtin periudhë të vitit të kaluar kanë qenë 43.573,02 euro.

Procedohet vendimi i Qeverisë për Pallatin e Rinisë

PRISHTINË, 7 SHKURT - Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, ka vendosur ta procedojë propozim-vendimin e Qeverisë për ta kthyer Pallatin e Rinisë në menaxhimin e Komunës së Prishtinës. Lajmin e ka bërë me dije nënkryetari i këtij komisioni, Dardan Sejdiu. "Me 5 vota për

dhe 1 kundër (PDK), Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal vendosi që të procedojë propozim-vendimin e Qeverisë për t'ua kthyer Pallatin e Rinisë qytetarëve të Komunës së Prishtinës. Pallati po bëhet i Prishtinës", ka shkruar Sejdiu në llogarinë e vet në "Facebook".



Latifi interesohet me nivelin e arsimit në Rahovec

RAHOVEC 7 SHKURT - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, i shoqëruar edhe nga nënkryetari i komunës Fatmir Iska dhe Avni Morina, drejtor i Arsimit, kanë vizituar ShM "Xhelal Hajda-Toni" dhe ShML "Selajdin Mullabazimi-Mici" në qytetin e Rahovecit. Gjatë vizitës në të dy institucionet shkollore janë takuar me stafin udhëheqës të shkollave dhe me mësimdhënësit, ku temë e takimeve ishin problemet me të cilat përballlet arsimi në nivel komunal në përgjithësi. Në të dy takimet,



kryetari Latifi ka shprehur gatishmërinë që në vazhdimësi të përmirësohet gjendja në arsim. Ai ka kërkuar nga mësimdhënësit të punojnë me seriozitetin më të madh.

Hani i Elezit dhe Tetova pajtohen për bashkëpunim

HANI I ELEZIT, 7 SHKURT - Kryetari i Komunës së Hani të Elezit, Rufki Suma, ka pritur në takim zyrtarë nga Komuna e Tetovës në krye me Xhelal Ceka, drejtor i Shërbimeve Publike në këtë komunë. Mysafirët nga Komuna e Tetovës i kanë uruar kryetarin Suma dhe nënkryetarin



Mallzum Qajani me rastin e zgjedhjes së tyre në krye të kësaj komune. Ata në emrin e tyre dhe të kryetares së Tetovës, Teuta Arifi, kanë shprehur gatishmërinë për bashkëpunim në fusha me interes të përbashkët.

Gjakova merr mbështetje të fuqishme nga Qeveria

Q. RAMA

GJAKOVË, 7 SHKURT - Kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, të mërkurën ka pritur në takim tre ministra dhe një zëvendësimistër të Qeverisë së Kosovës: Albena Reshitaj, ministere e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Pal Lekaj, ministër i Infrastrukturës, Kujtim Gashi, ministër për Kulturë, Rini, Sport dhe Çështje jo Rezidente, Selami Shkodra, zëvendësimistër i Punëve të Brendshme.

Qëllimi i kësaj vizite ishte rikonfirmimi i Qeverisë së Kosovës për përkrahjen e pazezërvë për projektet e Komunës së

Gjakovës, me ç'rast edhe u përmenden disa nga projektet më të rëndësishme që tashmë pritet të realizohen me përkrahjen e nivelit qendror. Gjatë takimit, kryetari Gjini dhe ministri Lekaj nënshkruan memorandumin për përkrahjen e së paku pesë projekteve në Komunën e Gjakovës, në vlerë prej rreth 18 milionë euro, mes të cilëve edhe projekti për unazën e qytetit, projekt i cili do të kushtojë tetë milionë euro dhe do të financohet në tërësi nga Qeveria e Kosovës.

Projekte konkrete u diskutuan edhe me ministren Reshitaj, ndërsa prioritet pati projekti për rehabilitimin e lumenjve të

Gjakovës, trajtimi i ujërave të zeza dhe vazhdimi i projektit për ujën e pijes në regionin e Rekës së Keqe.

Në aspektin e sportit, kulturës dhe rinisë, Gjakova do të përfitojë projekte edhe nga MKRS-ja, pasi ministri Gashi ka bërë me dije se kjo ministri do të vazhdojë me projektin e fushave të tenisit në Shkugëz, ndërtimin e stacionit të futbollit me barë sintetik po ashtu në Shkugëz, ndërtimi i qendrës së kulturës në fshatin Rogovë si dhe ndërtimin e kompleksit edukativo-rinor në fshatin Pjetërshah, si një prej projekteve rinore me karakter regional.

Kryetari i Komunës së Gjakovës,



Ardian Gjini, pasi e ka mirëpritur këtë gatishmëri të Qeverisë së Kosovës për të investuar në

Gjakovë, ka thënë se kjo është një fitore e madhe për Gjakovën dhe banorët e kësaj komune.

KRU 'Prishtina' shton bashkëpunimin me Komunën e Prishtinës

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 7 SHKURT - Kryeshefi ekzekutiv i KRU "Prishtina", Ilir Abdullahu dhe përfaqësues të tjerë të kësaj kompanie kanë pritur të mërkurën në takim drejtorin e Infrastrukturës së Komunës së Prishtinës, Gëzim Mehmeti, drejtorin e Urbanizmit, Ardian Olluri, dhe përfaqësues të tjerë të këtij institucioni. Gjatë këtij takimi që u mbajt në zyrat e Ujësllësit të Prishtinës, përveçse u diskutua për çështjet që kanë të bëjnë me të arriturat, sfidat dhe gjendjen e infrastrukturës së rrjetit të ujësllësit dhe kanalizimit, me theks



të veçantë në Komunën e Prishtinës, kryeshefi ekzekutiv i KRU "Prishtina", Ilir Abdullahu, ka ritheksuar përkushtimin maksimal kundrejt bashkëpunimit të

qëndrueshëm dhe bashkërendimit të investimeve, në funksion të ngritjes së efikasitetit dhe furnizimit sa më të mirë të qytetarëve të Komunës

së Prishtinës me ujë të pijshëm. Ai ka falënderuar udhëheqësit e dy drejtorive më të rëndësishme të Komunës së Prishtinës për gatishmërinë e tyre personale dhe institucionale, për mbështetjen e projekteve që ndërlidhen me investimet në rrjetin e ujësllësit, në veçanti të rrjetit të kanalizimit për Komunën e Prishtinës.

Nga ana tjetër, drejtorët e dy drejtorive përkatëse u zotuan ta mbështesin krijimin e grupeve të përbashkëta punuese (të iniciuara nga të dyja palët) me qëllim të analizimit të saktë të gjendjes në terren, harmonizimit të investimeve dhe përmirësimit të vazhdueshëm të nivelit të shër-

bimeve të ujësllësit dhe kanalizimit ndaj të gjithë qytetarëve të Komunës së Prishtinës.

Pasi që takimi kishte në fokus edhe natyrën teknike të punimeve që bëjnë në aktivitet e saj, nga ana e drejtorit teknik Sokol Xhafa u potencua se është shumë i rëndësishëm bashkëpunimi me komunat, veçanërisht me këto dy drejtori, prej ku dalin edhe investimet më të mëdha. Pas këtij takimi të dyja palët u pajtuan që në takimin e radhës të arrihet dhe të nënshkruhet një marrëveshje bashkëpunimi për renditjen dhe përgjegjësinë e të gjitha çështjeve infrastrukturore, gjithnjë në shërbim të qytetarit.

Haskuka merr përkrahje nga Ahmeti

PRIZREN, 7 SHKURT - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka pritur në takim kryetarin e Prishtinës, Shpend Ahmetin, i cili ishte i shoqëruar nga deputeti Dardan Sejdiu. Gjatë këtij takimi u diskutua për shkëmbimin e përvojave në mes të Komunës së Prizrenit dhe të Prishtinës. Haskuka ka treguar se me Ahmetin kanë biseduar për përvojat e tij me qeverisjen e Komunës së Prishtinës si dhe mënyrat se si të përmirësohet funksionimi i administratës së Komunës së Prizrenit. "Shpendi më premtoi se do të asistojë nëpërmjet drejtorëve përkatës të tij për rifunksionalizimin e aparateve për dhënie të dokumenteve, sistem i cili do ta lehtësojë marrjen e dokumenteve nga ana e qytetarëve. E falënderova Shpendin për ndihmën e gjer-tanishme nga Komuna e Prishtinës", ka thënë Haskuka.



Hapet Kuzhina Qendrore në Prishtinë

PRISHTINË, 7 SHKURT - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka marrë pjesë të mërkurën në hapjen e Kuzhinës Qendrore, e cila do të i furnizojë me ushqim të gjitha çerdhet publike në kryeqytet. Ky objekt, që dikur ishte i braktisur, me inves-

tim të komunës është shndërruar në kuzhinë moderne, që ka kapacitet të prodhojë edhe më shumë sesa kanë nevojë aktualisht çerdhet tona. Punëtorët e Kuzhinës Qendrore u shprehën shumë të kënaqura me kushtet e krijuar në këtë objekt.



Kandidatja për presidente të Rusisë e sjell fushatën në Uashington

Vizita e Ksenia Sobchak në ShBA, vetëm gjashtë javë para zgjedhjeve në Rusi, ka shkaktuar befasi në mesin e liberalëve, të aktivistëve opozitarë dhe vëzhguesve politikë dhe i ka shtruar pyetjet lidhur me atë nëse Kremli po e përdor kandidaturën e saj për të nxitur dalje më masive të njerëzve në zgjedhje dhe për t'i ndihmuar Putinin në synimin e tij për ta fituar edhe një mandat gjashtëvjeçar në presidencë



UASHINGTON, 7 SHKURT - Ksenia Sobchak, personalitete e njohur televizive ruse dhe e bija e një mentori politik të presidentit Vladimir Putin, e ka sjell në Uashington fushatën e saj për zgjedhjet presidenciale ruse, duke thënë se ambiciet e saj politike janë të singerta dhe afatgjatë.

Vizita e kësaj politikaneje interesante në Shtetet e Bashkuara, vetëm gjashtë javë para zgjedhjeve në Rusi, ka shkaktuar befasi në mesin e liberalëve, të aktivistëve opozitarë dhe vëzhguesve politikë dhe i ka shtruar pyetjet lidhur me atë nëse Kremli po e përdor kandidaturën e saj për të nxitur dalje më masive të njerëzve në zgjedhje dhe për t'i ndihmuar Putinin në synimin e tij për ta fituar edhe një mandat gjashtëvjeçar në presidencë.

Duke folur në Qendrën për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare në Uashington, Sobchak ka indikuar, pos gjërave të tjera, se planifikon të takohet me zyrtarë të administratës lidhur me sanksionet ekonomike të ShBA-së, të imponuara kundër Rusisë gjatë viteve të fundit. "Ne shohim se marrëdhëniet tona tash janë në pikën më të ulët", tha ajo dhe ka shtuar se "qëllimi im është të bisedoj me njerëzit këtu, të jem e hapur dhe të them se Rusia nuk është Putin". "Rusia është vend i madh me ekonomi të madhe, që siç e dini ka armatim atomik dhe nuk është mënyrë e mirë e komunikimit ajo që ne tash veprojim", tha Sobchak duke folur në gjuhën angleze.

Ajo theksoi se dëshiron të jetë "ura e parë ndërmjet vendeve tona dhe të tregojë se bile gjatë fushatës sime presidenciale, kjo çështje është

shumë e rëndësishme për mua dhe për të gjetur ndonjë zgjidhje, ndonjë lidhje me njëri-tjetrin, me ç'rast ne, pak nga pak, të mund të krijojmë situatë më të mirë për të dy vendet tona".

Masat ndëshkuese

Sanksionet e para kundër Moskës, me bllokim të pasurive dhe ndalim të udhëtimit, Uashingtoni i ka ndërmarrë në vitin 2014, pasi Rusia e aneksoi Krimenë e Ukrainës dhe pas shpërthimit të luftës ndërmjet forcave qeveritare të Ukrainës me separatistët e mbështetur nga Rusia, në pjesën lindore të Ukrainës.

Masat pasuese ishin në përgjigje të gjetjeve të inteligjencës amerikane se Rusia ishte angazhuar në hakëzimet dhe fushatë propaganduese për të ndikuar në zgjedhjet presidenciale amerikane në vitin 2016. Këto sanksione kanë vazhduar edhe gjatë presidencës së Donald Trumpit, pavarësisht thirrjeve të tij për raporte më të mira me Moskën. Një legjislacion i miratuar nga Kongresi i ShBA-së verën e vitit 2017, parashihet masa të reja ndëshkuese kundër Rusisë, por javën e kaluar, Departamenti i Shtetit dhe ai i Thesarit kanë refuzuar të imponojnë sanksione të reja.

Sobchak, e njohur për paraqitjet televizive

Pritet gjerësisht që Putini do ta fitojë një mandat të ri gjashtëvjeçar në zgjedhjet e 18 marsit.

Ksenia Sobchak, emri i së cilës do të paraqitet në fletëvotime, është

shumë e njohur si personalitet që paraqitet në programe televizive. Babai i saj është Anatoly Sobchak, ish-prefekti i qytetit Shën Petersburg, i cili e ka sjell Putinin, atëherë oficer i panjohur i KGB-së, për të punuar në qeverinë lokale.

Ksenia Sobchak, babai i së cilës ka vdekur para disa viteve, e ka përsëritur kritikën e ambientit politik në Rusi, duke thënë se sistemi aktual është autoritar dhe se nuk ka iluzione për rivalitetin e saj ndaj Putinin. Ajo ka këmbëngulur se kandidatura e saj është shprehje e ambicieve të singerta politike dhe për ta krijuar një parti të re politike në Rusi. Ajo ka sugjeruar se favoriti i madh në zgjedhjet presidenciale është Vladimir Putini. "Sikur në kazino, kazinoja gjithmonë fiton. Në Rusi, Putini fiton gjithmonë", tha Sobchak.

Kundërshtari më i fuqishëm i Putinin është Aleksei Navalny, një luftëtar i paepur dhe karizmatik kundër korrupsionit, i cili e ka krijuar një platformë kombëtare, duke organizuar tubime kundër korrupsionit endemic. Por, atij Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në Rusi nuk ia ka lejuar të jetë kandidati për zgjedhjet presidenciale, për shkak të dënimit për krime të ndërlidhura me financa. Navalny dhe mbështetësit e tij vlerësojnë se këto dënime paraqesin hakmarrje politike për punën e tij kundër korrupsionit.

Prej momentit kur nuk i është lejuar pjesëmarrja në zgjedhje, Navalny kërkon bojkot të votimit, në përpjekje për ta reduktuar daljen e zgjedhësve dhe për të mos i mundësuar Putinin legjitimitet të gjerë. Ksenia Sobchak ka përsëritur disa herë se ajo nuk e mbështet bojkotin e zgjedhjeve.

LAJME SHKURT



Marrëveshje koalicioni në Gjermani

BERLIN, 7 SHKURT - Unioni Demokristian (CDU) i kancelares gjermane, Angela Merkel, dhe Partia Socialdemokrate (SPD) e qendrës së majtë, kanë arritur marrëveshje për koalicion, duke e përfunduar një paqartësi politike, që ka zgjatur më tepër se katër muaj. CDU konservatore dhe partia simotër e saj, Unioni Kristiansocial (CSU) nga Bavaria, dhe SPD-ja, ia dolën t'i kapërcejnë pengesat e mëdha, duke arritur marrëveshje pas negociatave përfundimtare 24-orëshe, që zgjatën deri të mërkurën. "Të lodhur, por të kënaqur. Kontrata është këtu, përfundimisht", ka shkruar të mërkurën në një mesazh në rrjetin, WhatsApp, partia SPD.

Politikani i partisë CSU, Alexander Dobrindt, tha se "është çështje kohe për perspektivën e Qeverisë në Gjermani".

Medie të ndryshme njoftojnë se socialdemokratët do të marrin tri poste të rëndësishme ministrore, atë të Ministrisë së Jashtme, Ministrinë e Financave, që deri më tani e kanë drejtuar konservatorët, dhe atë të Punës. Ndërsa kristiansocialët do të marrin Ministrinë e Brendshme, ku ministër pritet të bëhet kreu i partisë, Horst Seehofer. Konservatorët e CDU do të marrin pjesë për Ministrinë e Ekonomisë dhe të Mbrojtjes.



Trumpi kërkon paradë ushtarake në Uashington

UASHINGTON, 7 SHKURT - Presidenti amerikan, Donald Trump, ka kërkuar nga Pentagoni që të planifikojë një paradë të madhe ushtarake në Uashington, gjatë vitit 2018, për ta treguar fuqinë ushtarake të Shteteve të Bashkuara.

Për këtë plan është raportuar së pari të martën nga e përditshmja "Washington Post" dhe menjëherë pas kësaj është konfirmuar nga zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë, Sarah Sanders. Këtë kërkesë Trumpi e ka bërë gjatë takimit të 18 janarit me zyrtarët e lartë ushtarakë, pasi raportohet se ishte i impresionuar me paradën franceze për Ditën e Bastilës në Paris, në vitin 2017.

"Washington Post" ka raportuar se Trumpi dëshironte një paradë të përgatitur mirë gjatë vitit 2018, por asnjë datë nuk është shpallur. "Presidenti Trump është mbështetës i fuqishëm i antarëve të shërbimit të madh të Amerikës, të cilët e rrezikojnë jetën e tyre çdo ditë për ta siguruar vendin tonë", tha Sarah Sanders.

Recension / Kujtesa popullore për historinë e një lufte (2)

Historia dhe kujtesa popullore



Prof. dr. Nusret PLLANA

Nëse shqyrtohen me kujdes ngjarjet dhe të dhënat që ka sistemuar në veprën e tij Bedri Tahiri, mund të thuhet se ngjarjet nuk flasin vetëm për luftën e Drenicës, apo vetëm me veprimtaritë që lidhen me këtë luftë. Pra, është marrë me një shumë episodesh të ngjarjeve të ndryshme andaj, rrjedhimisht, edhe me një shumë personalitetesh historike, si dhe me një numër pjesëmarrësish të tjerë, një pjesë të të cilave deri tashti nuk i ka shënuar kujtesa historike e shqiptarëve. Por, i ka mbajtur mend, i ka ruajtur kujtesa popullore, që në këtë rast janë shpaluar përmes kujtesës së plakut të urtë dhe atdhetarit të devotshëm, Asllan Jashari.

Mënyra si i ka sistemuar të dhënat për ngjarje të caktuara, autorit Bedri Tahiri i ka dhënë dorë që edhe ta ruajë kronologjinë e rrëfimit të një njeriu, i cili mund të quhet pjesë e kujtesës sonë, duke sjellë edhe të dhëna nga burimet historike, por edhe ta shqyrtoj veprimtarinë atdhetare të disa figurave të rëndësishme të historisë sonë, edhe para Luftës së Drenicës, edhe pas kësaj lufte. Do të thotë, në veprë zënë vend edhe luftëtarë të ngjarjeve të ndryshme luftarake, veprimtaria e të cilëve është zhvilluar në vende të ndryshme të gjeografisë së Drenicës së kohës së Luftës së Dytë Botërore, siç ishte fjala Rifat Galica, apo Xhemë Tërnaçci, por edhe luftëtarë e komandantë që i kanë prirë edhe Luftës së Drenicës, edhe Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, siç ishte fjala vjen, Mehmet Gradica, apo Komandanti Legjendar, Adem Jashari. Autori i veprës Lufta e Drenicës sipas rrëfimeve të Asllan Jasharit, Bedri Tahiri, ka zgjedhur një mënyrë origjinale të qasjes për temën që ka marrë në trajtim. Duke u mbështetur në rrëfimin e një luftëtarit të Luftës së Drenicës, të Asllan Jasharit, i cili, siç thotë autori, kishte kujtesë të shkëlqyeshme, brenda strukturës së veprës së tij, ka krijuar natyrshëm hapësira, për të sistemuar të dhëna edhe për disa nga figurat kryesore, jo vetëm të periudhës së Luftës së Drenicës, por edhe të periudhave të tjera kohore. Në fillim, pasi ka shpjeguar, sipas njohurive të plakut të

urtë, Asllan Jasharit, se që të gjithë ata për të cilët ka rrëfyer, si dhe familje të tjera të mëdha, jo vetëm në Prekaz, por edhe në disa fshatra të tjerë të Drenicës dhe të Dukagjinit, janë të fisit Kuç, ai ka vënë në spikamë disa karakteristika të pjesëtarëve të këtij fisi. Mirëpo, në mënyrë të veçantë ka theksuar sidomos aftësinë luftarake të pjesëtarëve të këtij fisi dhe, veçanërisht është ndaluar dhe ka folur, sidomos për trimërinë e tyre. Autori, bashkë me rrëfyesin, papritur kanë lënë rrëfimin e kujtimeve. Mirëpo, është gjetur rasti dhe momenti dhe ka dhënë një jetëshkrim mjaft të detajuar për Adem Jasharin, si dhe për Hasan Prishtinën. Doemos, dy nga figurat kryesore të dy periudhave më të ndritshme të historisë së re shqiptare, njëri ideator dhe bartës i kryengritjeve për shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë dhe ruajtjen e tërësisë së saj territoriale, Hasan Prishtina, tjetri, Komandanti Legjendar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i cili ishte bartësi i Ushtrisë që çliroi këtë pjesë të pushtuar të tokave shqiptare.

Lufta e Drenicës dhe liria e Kosovës

Në një pjesë të veprës së tij, menjëherë pas jetëshkrimit të Hasan Prishtinës, autori është ndaluar te disa aspekte të çështjeve, të cilat krijojnë hallka në rrëfimin e plakut Asllan Jashari. Thënë më mirë dhe më saktë, krijojnë një lidhëse në strukturën e veprës së tij, ku i mundësohet edhe autorit, për të dhënë gjendje të caktuara shpirtërore, qoftë të rrëfimit, qoftë të autorit, por, qoftë edhe të të pranishmëve në vendet ku bëhej mbajtja e shënimeve për rrëfimet e këtij plakut. Në strukturën e veprës së tij, autori Bedri Tahiri, ka radhitur ngjarje të periudhave të ndryshme kohore, herë ngjarje që kishin ndodhur shumë kohë para Luftës së Drenicës, herë të tjera ngjarje që kishin ndodhur edhe pas Luftës së Drenicës, ku bartës kryesor të veprimeve luftarake ishin shqiptarët, në mesin e të cilëve doemos kishte edhe më të dalluar. Në tërësinë e rrëfimit të episodeve të ndryshme, janë dhënë fragmente, për të mos thënë aspekte të atyre ngjarjeve, por përherë duke theksuar pjesëmarrjen e shqiptarëve në ato ngjarje, rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre, si dhe pasojat që kishin ato ngjarje në jetën historike të popullit shqiptar. Plaku i mençur, Asllan Jashari, rrëfimtari kryesor i veprës së Bedri Tahirit, Lufta e Drenicës,


sipas rrëfimeve të Asllan Jasharit, ka shpaluar momente të periudhave kohore ku, siç rrefen ai, shqiptarët kanë luftuar edhe për të huajt. Episodet e rrëfimit të kujtimeve të tij prekin edhe kohën e luftërave ruso-turke, apo edhe të luftërave të tjera, ku të shumtën e herëve, shqiptarët ishin pjesë e ushtrive të huaja dhe luftonin për interesa dhe toka të huaja. Mirëpo, ka ngjarje ku roli i shqiptarëve ishte vendimtar për të ruajtur, së paku bërthamën biologjike të pjesëtarëve të një populli, siç ishte rasti me plojnë që ishte bërë mbi vëllezërit myslimanë, të anës së Pazarit të Ri, Bihorit, e vendbanime të tjera, apo edhe mbi një pjesë të fshatrave shqiptare të këtyre anëve. Organizimi, mënyra e ndërtimit të strategjive luftëtarake, pjesëmarrja në ato ngjarje, dëshmojnë për përkushtimin e luftëtarëve shqiptarë në mbrojtjen e vendit të tyre, si dhe gatishmërinë që të sakrifkohen, qoftë edhe për të shpëtuar jetën e një fëmije. Diku në pjesë të caktuara të veprës së tij, autori ka futur edhe rrëfimin e plakut Asllan Jashari, për mënyrën e organizimit dhe të rekrutimit të vullnetarëve shqiptarë (të gjynlive, siç i kanë quajtur me përkufizimin e fjalorit ushtarak osman), të cilët shkonin për të luftuar për vende të huaja. Pastaj, autori ka shkëputur ndonjë pjesë të rrëfimit të ndonjë ngjarjeje, edhe si përjetim emocional, por në radhë të parë, rrëfimi del si qortim që i ka bërë historia njeriut shqiptar, që nuk arrinte të bëhej bashkë e dhe të luftonte për lirinë e tokave shqiptare. Në shumësinë e ngjarjeve të rrëfyer, ka të tilla që janë bartur me saktësi kujtese, gjë që dëshmojnë edhe me të dhëna plotësuese, qoftë kur autori ka përdorur ndërhyrjet shkrimore, në formën e intermeceve, qoftë kur ka folur dhe ka dhënë jetëshkrimin e pjesëmarrësve në ato ngjarje. Ndër rrëfimet më të veçanta, janë edhe luftimet

në Artakoll, kundër bandave çetnike, siç i quan, edhe kjo, thënë kushtimisht, një derë hyrëse në pjesë të ndryshme të Drenicës, e cila asnjë herë nuk ishte pajtuar me pushtuesin. Përkushtimin për lirinë e ka shpaluar në kujtimet e tij plakut i urtë Asllan Jashari, sidomos kur rrefen për kthimin e Shaban Polluzhës me Brigadën e tij në Drenicë, duke mos pranuar të shkonte nëpër tokat serbe për të ndjekur ushtrinë gjermane që kishte humbur luftën. Po atë natë kur Shaban Polluzha ishte në Besianën e sotme, ish-Podujevë, në Drenicën e tij ishin pushkatuar disa nga trimat më të shquar të luftës për liri. Në Besianën e sotme ishin dy brigada shqiptare, ajo që i printe Shaban Polluzha, dhe Brigada e Shtatë Shqiptare, e Ushtrisë Shqiptare, që i printe Shaban Haxhia. Me këtë rast, siç kujton edhe plakut Asllan Jashari, Komandanti i Shtabit Suprem të Drenicës, Shaban Palluzha, u drejtohet luftëtarëve të brigadës së tij, pasi nuk kishte pranuar të nisej për në Serbi, përkundër ndërhyrjeve, edhe të udhëheqësve shqiptarë të asaj kohe, edhe të atyre serbë. Shaban Palluzha u thotë luftëtarëve të tij: "Vëllazen, deri dje ishim partizan dhe luftuam kundër gjermanëve për me e çlirue Kosovën tonë të dashur. Sot e tutje jemi luftëtarë të lirisë dhe do të luftojmë kundër bandave çetnike që janë lëshuar mbi trojet tona. Sot po i shpallim luftë Serbisë dhe komunistëve që po këqyrin me na farue. Tash po nisemi për Vushtrri. E vetmja rrugë për të dalë në Nyqavicë është Ura e Pestovës. Na priftë e mbara!" Në anën tjetër, një rrëfim shumë interesant dhe domethënës, është figura e Shaban Haxhi Demaliaj, njëri nga komandantët në zë të Ushtrisë Shqiptare, i cili, edhe pse e kishte nënshkruar urdhëresën për nisje, e dinte se ajo ishte rrugë e tradhtisë së interesave kombëtare. Por, ai

dubej të zbatonte urdhrat e epërëve të tij, të cilët ende i besonin vëllazërim-bashkimit të ideologjisë komuniste me sllavët. Prandaj, janë të paharueshme fjalët që ai ia drejton Shaban Polluzhës, kur ai bashkë me brigadën e luftëtarëve të Drenicës kishte marrë vendim të kthehej në Drenicën e tij dhe të mbronte gratë, fëmijët, pasuritë, tokën e Drenicës. Komandanti i njohur Shaban Haxhia, me një gjuhë të qartë atdhedashurie i drejtohet Shaban Polluzhës: "Unë, Shaban Haxhia, po shkoj dhe, edhe nëse shp'etoi, ka me mu sha n'na, kurse ti, o Shaban Polluzha, po kthehesh dhe, edhe nëse vritesh, ka me tu këndue kënga!" Rrëfimi i plakut të urtë, Asllan Jashari, pastaj jep me saktësi gjithë rrugëtimin e Brigadës së Komandant Shaban Polluzhës, pritat dhe vrasjet prapa shpine, përgjimin e vazhdueshëm dhe ndjekjet hap pas hapi, përpjekjet për të përçarë ushtarë dhe njësi të brigadës së tij, pasi nuk kishte lavdishme dhe tmerrin e acarit të atij dimri të paharueshëm, luftimet e ashpër me forcat komunisto-çetnike, masakrat në fshatra të Drenicës, por edhe qëndresën e madhe të luftëtarëve të lirisë që kanë mbetur shenjë atdhetarie në kujtesën tonë historike.

Përfundim

Vepra më e re e autorit Bedri Tahiri, Lufta e Drenicës, sipas rrëfimit të Asllan Jasharit, lexuesit i vë përpara një mënyrë tjetër të trajtimit të ngjarjeve historike, të zhvilluara brenda një treve të caktuar, siç është Drenica, duke shpaluar me kujdes dhe me qartësi anën themelore të asaj lufte: luftë për liri kombëtare. Qoftë vetëm për këtë fakt të pamohueshëm të këtyre rrëfimeve, si dhe të mbarështrimit të gjithë atyre episodeve të ngjarjeve të ndryshme dhe të pjesëmarrësve të ndryshëm, është e mjaftueshme për të folur për rëndësinë e kësaj veprë, që në një mënyrë apo në një tjetër, plotëson ato zbrazëti që ka lënë historiografia e deritashme shqiptare, sidomos kur ka marrë në shqyrtim Luftën e Drenicës, por edhe luftëtarët e saj. Shqiptarët e kësaj pjesë të gjeografisë kombëtare, të Kosovës pra, duhej ta prisnin Luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me Komandantin e saj Legjendar, Adem Jasharin, për ta vlerësuar drejt Luftën e Drenicës dhe Komandantin e saj, Shaban Polluzhën, edhe pse dilemat historike vazhdojnë edhe më tutje. (Fund)



Johannes Gutenbergu i mistershëm, shpikësi i shtypjes së librave



Me shpikjen prej tij të shtypshkronjës ai konsiderohet si ati i komunikimit masiv. Por a ka qenë vërtet ai i pari që shtypi libra? Edhe 550 vjet pas vdekjes së Gutenbergut, shumë çështje mbeten pa përgjigje.

Të gjithë e njohin Johannes Gutenbergun, megjithëse për të thuhet nuk dihet asgjë, thotë zëvendësrektorja e muzeut Gutenberg në Mainz, Elke Schutt-Kehm. Kjo nis që me ditën e tij të lindjes dhe përfundon me datën e vdekjes, me të cilën ka lidhje përkujtimi i sivjetshëm i 550 të vdekjes së Gutenbergut. Vetëm kaq dihet: Johannes Gutenberg është shpikësi i shtypjes së librave me gërma të lëvizshme metali dhe me këtë ai kontribuoi në mënyrë vendimtare në suksesin e Reformacionit. Për këtë gazetarë amerikanë e zgjedhën atë "njeriun e mijëvjeçarit". Ai lindi rreth vitit 1400. Ndoshta në Mainz, por ndoshta

edhe në Eltvite në anën tjetër të Rinit në Rheingau. Ai vinte nga familja e pasur tregtare Gensfleisch. Më vonë ai e ndryshoi emrin e lindjes, siç ishte moda atëherë, dhe mori emrin e rezidencës së familjes "Hof zum Gutenberg".

Përgatitje në Strasburg

Ndoshta Johannes Gutenberg studioi në Erfurt. Këtë e tregon një shënim në regjistrat e Universitetit. Rreth vitit 1428 familja Gensfleisch u largua nga Mainzi për shkak të konflikteve midis familjeve drejtuese të qytetit. Se ku qendroi pas kësaj Gutenbergu, nuk është dokumentuar. Qëndrimi i tij dokumentohet sërish në vitin 1434

Strasburg. Në këtë qytet, që sot është qytet francez, atij ju ofruan mundësi të shumta fitimi. Gutenbergu punoi atje ndër të tjera në zejjet e monedhave dhe të argjendarisë, themeloi një shoqëri financiare dhe prodhoi objekte për t'i marrë me vete në pelegrinazhe. Ai kaloi atje gjithsej dhjetë vjet.



Suksesi në Mainz

Pasi u kthye në Mainz ai vazhdoi punën për shtypjen e librave me ndihmën e tregtarit Johannes Fust dhe të shkruarit Peter Schöffer. Midis 1452 dhe 1454 puna përfundoi: u prodhuan gërmat e tij metalike të lëvizshme. Dhe meqenëse Gutenbergu qe mekanik i aftë dhe njëkohësisht sipërmarrës që i hynte rrezikut, ai ndërtoi për to edhe shtypshkronjën manuale me levë. Për shekuj të tërë librat qenë shkruar me mundim me shkrim dore, shumicën e herëve në dhomat e shkrimit të manastireve. Vetëm

kleri dhe shtesa e lartë mund t'i blenin ato produkte të shtrenjta - pa folur për leximin. Kurse tani gërmat mund të shtoheshin si dëshiroje, fjalë dhe fjali të tëra mund të hidheshin në faqe - dhe e gjitha të riprodhohej sa herë të doje. Një shpikje që e revolucionarizoi shkëmbimin e dijes dhe solli ide të reja në popull me tirazh të lartë - për kushtet e Mesjetës. Në vitin 1450 mjeshtri ndër-mori punën më ambicioze të tij: brenda dy vjetësh ai shtypi me ndihmën e 20 të punësuarve të tij 180 kopje të Biblës së Luterit. Bibla është jo vetëm vepra e parë, por edhe libri më i bukur, që është shtypur ndonjëherë, mendon Elke Schutt-Kehm. Teknika e Gutenbergut u shpërnda tepër shpejt. Në vitin 1500 shtypshkronja në të gjithë Evropën prodhonte jo vetëm vepra dijetarësh, por edhe shkrime denigruese kundër tregtisë së certifikatave të faljes së mëkateve. Rreth 100 vjet më vonë u shfaq gazeta e parë.

Model Azia?

Po a ishte Gutenbergu i pari që e mundësoi shtypjen e librit? Përgjigja është: jo. Shtypja e librave me gërma të këmbëbyeshme që shpikur që në shekullin e 11-të në Kinë dhe që përhapur në shekullin e 13-të edhe në Kore. Por në një kohë kur në Azi gërmat gdhendeshin me procese të derdhjes së dyllit ose gdhendeshin në dru, Gutenbergu shpiku një teknikë krejt të vetën me një instrument që pikonte bojën dhe me një shtypshkronjë me levë. Ai është "i pari që konceptoi një prodhim serial të pjesëve të veçanta të standardizuara", thotë Schutt-Kehm. Kjo ishte një metodë e re dhe një hap shumë i madh në historinë e teknikës. Në 3 tetor në Mainz dhe jo vetëm aty kremtohet 550 vjetori i ditës së vdekjes së pionerit të mediave - edhe nëse shkencërisht për 03.02.1486 si datë të vdekjes ka diskutime e mendime që e kundërshtojnë. DW




Aktori i famshëm mbush 40 vjeç



Karrierën e ka nisur në moshë shumë të re në fushën e modës, për të vazhduar më pas në atë të kinematografisë. Bëhet fjalë për Ashton Kutcher, i cili, falë serialit televiziv "That '70s Show" në vitin 1998, arriti të

depërtonte në botën e spektaklit. Aktori ka festuar ditëlindjen e 40 nën shoqërinë e familjarëve dhe miqve më të ngushtë. Në vitin 2005 Ashton u martua me aktoren Demi Moore, me të cilën u divorcua në vitin 2013.

Celine Dion dhe kujtimet për njeriun e zemrës



Humbja dy vjet më parë e njeriut të saj të zemrës ende vazhdon të mbetet plagë e madhe për të. Bëhet fjalë për këngëtarën e famshme Celine Dion, e cila dy vjet më parë humbi

bashkëshortin, i cili vdiq nga sëmundja e kancerit. "Edhe pse ai ka ikur, unë ende vazhdoj të flas me të. Angelil gjithmonë ka dashur që unë të vazhdoj të performoj në skenë", ka thënë Dion.



Rita Ora, mahnitëse në premierën e "Fifty Shades Freed"

Këngëtarja me origjinë shqiptare Rita Ora ka realizuar kolonën muzikore të "Fifty Shades Freed" në bashkëpunim me Liam Payne. Ylli i muzikës pop tërhoqi vëmendjen

e të gjithëve në premierën e filmit që u mbajt mbrëmjen e së martës në Paris. 27-vjeçarja e veshur me një kostum të bardhë tregoi format trupore elegante dhe dukej mjaft tërheqëse.

Elton Johni anulon koncertet



Këngëtari i njohur Elton John është mik i ngushtë i familjes mbretërore dhe ka pasur marrëdhënie të ngushta me princeshën Dianën. Ylli i muzikës

thuhet se ka anuluar dy koncerte për të marrë pjesë në dasmën mbretërore të princ Harryt dhe Meghan Markle në muajin maj, raporton "The Sun".



Autor: GAZMEND MORINA	HUMBJA E AFTËSISË PËR TË LËVIZUR	SHKRIMTARE E JONA	GJYQAR SPORTIV	FUSHA KU ZHVILLOHET NJË PËRLESHJE (fig.)	DJALI KUNDREJT TË VET (pashq.)	SHTET NË AZI (pashq.)	KONOPI	ZANORE	EPOKA ERE	PIANISTJA LULE	KËNGA E POPULARI-ZUAR
VUJA E LAKUAR E HAPUR, QË PERFOTHEK KUR ME NJË RRAFSH PARALEL									ELIZA HOXHA SULMIMI		
ANËTARËSIMI NË NJË ORGANIZATË								LETRARI ASLLANI			
KUMTIM I GJERË ME SHKRIM, QË MBAHET PARA NJË MBLËDHJEJE								VITI I RI KINEZ (pashq.) GOJËDHËNA			
AKTORI FRANÇEZ DELON					FALJA FETARE QË BEJNË DISA HERË NË DITË MYSLIMANËT SKLLAVI I LIRUAR						
AKTORI YNË ÇELAJ							KËNGËTARI I FAMSHEM MARTIN KËNGËTARJA AMERIKANE TARNER				MJET I THJESHTE LUNDRIMI (shq.)
INDIUM			VULGARE, E NDYRE	PEZMATIMI I VESHIT THIRRJA E MYEZINIT							BASHKËTING LUMË NË KOSOVË
KORJIA							EMËR YNI MASHKULLI PJESE E BRENDSHME E KEMISHES				

EPOKA ERE	FUTBOLLISTI HOLANDEZ NË FOTO (BAYERN MUNICH)	SUPER MODELJA ANGLEZE CAMPBELL	VESHJE E TRASHË, E BËRË ME LESH DMIË SI NJË PELERINË (krah.)	OHAJO, FLORIDA	BASHKËTING	FEMRA LUFTËTARE (mit greke) ZHVILLIM JONORMAL			ARMATA REPUBLIKANE IRLANDEZE (shq.) I MITUR, KALAMA			
SHTET NË AFRIKË	○					PEMË E VENDEVE TROPIKALE (shq.) ISMET MUNISHI					EVA PEPAJ PRINC ARAB (shq.)	
KOMPOZITORI DHOMI	○				ISH TRAJNERI YNË I BOKSIT LAH PAJISJE PËR ALARMIM (sh.shq.)					MJET UDHËTIMI (shq.) PËRÇARJE		
DET I YNI	○			SHTET NË AFRIKË (pashq.) DEVE E VENDEVE TË AMERIKËS (sh.shq.)					MUZIKANTI KRASNIQI (shq.) JETA E QETË DHE E LUMTUR			TINGULL QË FORMOHET NË MAJË TË GJUHËS (gram.)
SMALTIM	○					JA (bised.) RENS ISTVUD		INDIAN DEFENCE REVIEË E KUJDESSHME NË VEPRIME			U ARRATISA NGA BURGU POLITIKANI SHEHU	
NORA ISTREFI	○		BUJKU ARIAN MALIQI				SOLISTJA ... ZARI NJULLOSJA			ORGANIZMI I NJERIUT (pashq.) SHFUQIZIM		
BASHKËTING	○	BAR PËR TË DALË JASHTË (shq.) SHKARKIMI NGA NJË POZITË									ZANORE ROBERT REDFORD	
RAFTI, DOLLAPI	○					DIKTATOR SOVJETIK (shq.) PRARQJ					RIFAT KUKAJ SKUADRA SPORTIVE	
BETIM	○		TONY ANDERSON BERTHAMOR			NJËRI NGA AKUZUESIT E SOKRATIT ENVER PETROVCI				U THAVA BASHKËTING		
SUPER MODELJA HERZIGOVA	○			KA A DEM I PATREDHUR (shq.) LLOJ PAPA GALLI					BURRË I MOSHUAR RROGA VJETORE E PAPËS			SHKRONJA XVI LLOJ PJE E NGRËHTË ORIENTALE
SHENJA QË PËRFAQËSON NJË TINGULL MUZIKOR	○				FJALE POUHESE AKTORI HOLLIVUDIAN PIT		FRYMA VEZAK, QË ESHTË NË TRAJTË TË VEZËS		I FILLOVE ONTARIO LACROSSE ASSOCIATION			
TOKË ME TË ARDHURA VJETORE DERI NJËZET MIË AKËE NË VIT, QË U JEPËJ NË ZOTËRIM FEUDALEVË SPARINJ NË PERANDORINË OSMANE (shq.)	ZOG ME TRUP TË MADH E ME PENDE TË ZEZA TANTAL FOSFOR					NË DITËN E SOTME IPSVICH		LIGJ (vjet.) "TOP ALBANIA RADIO"			MINUS (Mat.) BUKURI, HUESHI	BISHË MALI (pashq.)
EMËR FEMRE MYSLIMANE						QË KA TRUP TË SHËNDOSH, JETËDHËNËS, BASHKËT.				MUZIKANTI ADRIAN RADIUM		EDUARD ROSTON ZANORE
LLOJ LOJE ME SHIGJETA TË VOGLA						MUNGËSË E SHTYRJES, E VARËSISË DHE E KUFIZIMEVE			ZEZAKU, I ZIU			

E jashtëzakonshme

Njeriu më leshatak në botë

Larry Gomez është quajtur 'Njeriu ujk' sepse 98% të trupit të tij është i mbuluar nga qime, duke përfshirë fytyrën. Gomez i San Bernardino, Kalifornia, ka lindur me hypertrichosis kongjenitale të përgjithshme, një çrregullim gjenetik i rrallë që godet më pak se 100 njerëz në mbarë botën. Në moshë të vogël ai ka rënë pre e bullizmit pasi fëmijët e ngacmonin dhe e largonin për shkak të pamjes së tij të pazakontë.



FOTO E DITES



Një djalë në Indi qëndron mbi elefantin në lumin Yamuna në New Delhi. /Reuters/

E rrallë

Adoleshentët që punojnë si varrmihës

Ellie dhe Ben janë dy adoleshentë që kanë zgjedhur një profesion jo shumë të përshtatshëm për moshën e tyre. Vetëm 17 vjeç dhe punojnë si varrmihës. Ellie përgatit të vdekurit për në banesën e fundit, ndërsa Ben merret me transportin e tyre. Ellie thotë se përballet me reagime mjaft të çuditshme kur u tregon miqve për profesionin e saj.



BARSOLETA E DITËS



Mërgimtari:

- O vëlla, qysh je? Jam qorruar për Kosovën.
- Po kthehu, o vëlla, se s'po di ç'të them tjetër!
- Vëlla, po të them se jam qorruar, po hala nuk më kanë lënë mendtë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00

“FERDINAND”

3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 46 min

Rolet: John Cena, Kate McKinnon, Gina Rodriguez, Daveed Diggs, Gabriel Iglesias, Bobby Cannavale, David Tennant, Anthony Anderson, etj.
Regjia: Carlos Saldanha



Në ora 18:00 dhe 20:00 (R) “FIFTY SHADES FREED”

Dramë/Romansë/Triller; 1 orë 41 min

Rolet: Dakota Johnson, Jamie Dornan, Eric Johnson, Rita Ora, Luke Grimes, Victor Rasuk, Jennifer Ehle, Eloise Mumford, Max Martini, Callum Keith Rennie, Bruce Altman, Arielle Kebbel, Robinne Lee, Brant Daugherty, Marcia Gay Harden, etj.
Regjia: James Foley

Në ora 22:00 (PG-13)

“THE COMMUTER”

Krim/Dramë/Mister; 1 orë 44 min

Rolet: Liam Neeson, Vera Farmiga, Patrick Wilson, Jonathan Banks, Sam Neill, etj.

Regjia: Jaume Collet-Serra



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: **Kino ABC**.



DASHI

Edhe pse sot do të keni shumë punë, do të jeni të qetë dhe do të organizoni gjithçka që ju del papritur.



DEMI

Edhe armiqtë në raste të veçanta kthehen në miq të mirë. Kjo thënie vlen për ju sot sepse një kundërshtar i betuar do të dalë në anën tuaj.



BINJAKËT

Sot do të jetë një ditë e qetë pas stres. Çdo gjë po shkon siç e keni programuar dhe juve do t'ju krijojë mjaft momente të lira gjatë ditës.



GAFORRJA

Sot do t'ju kujtohen shumë momente të këndshme nga fëmijëria që do të doni t'i rjetonin nën një aspekt tjetër.



LUANI

Familja do t'ju falë më tepër dashuri nga sa duhet. Kjo do të bëjë të ndiheni shumë të izoluar nga pjesa tjetër e ambientit shoqëror.



VIJGJËRËSHA

Sot po bashkëbisedoni me njerëz që shumë shpejt do të jenë miqtë tuaj më të mirë. Njohjet e reja ju sjellin shumë surpriza.



PESHORJA

Kujtimet do të jenë kurthi juaj në këtë ditë. Do të keqinterpretoni disa situata vetëm për shkak të kujtimeve të trishtta.



AKREPI

Sot do të keni debate të ashpra me një koleg pune. Do të krijoni një situatë të pakëndshme.



SHIGJETARI

Karakterit juaj gazmor dhe plot ngjyra nuk shkon fare me këtë ditë që paraqitet shumë e qetë. Ndonjëherë edhe pak tonalitet neutral ju bën shumë mirë.



BRICJAPI

Ambicia është pjesë e karakterit tuaj dhe ju e shfaqni pa problem. Në shumë raste është një gjë mjaft e mirë.



UJORI

Ju pëlqen ambienti në të cilin punoni dhe, pavarësisht prej stresit, ju e bëni me qejf punën tuaj. Gjithmonë jeni të pavarur në mendime, kurse sot do të shkëlqëni.



PESHQIT

Marrëdhënie me partnerin. Po toleroni ngarkesat e njëri-tjetrit në punë dhe kjo gjë ju ka afruar më tepër.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Adri: Fushë Kosovë
Mobi: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

ADO DEN HAAG - VITESSE

2

FEYENOORD - FC GRONINGEN

GG3+

GALATASARAY - KONYASPOR

GG3+

Salihu: Besa nuk refuzohet, mbijetesa nuk diskutohet

Shkëmbim Salihu ka bërë me dije se ka refuzuar në janar oferta të tjera për t'iu bashkuar Besës së Pejës, kurse beson se ky klub do të arrijë pa ndonjë problem mbijetesën në Vala Superligë. "Me punën që jemi duke bërë dhe me potencialin që kemi brenda skuadrës jam i bindur se mbijetesa nuk do të diskutohet, ani pse nuk do të jetë e lehtë nëse e shikojmë nga pozita aktuale në tabelë", ka thënë Salihu

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 7 SHKURT - KF Besa gjithmonë në gjirin e vet ka pasur sulmues të spikatur si Haxhi Zeka, Fitim Haliti, Krenar Vokshi, Kastriot Rexha, Xhevdet Shabani, kurse tash kjo skuadër që nuk e pretendon më titullin e kampiones, por mbijetesën në krye të sulmit e ka angazhuar Shkëmbim Salihun, i cili ka qenë pjesë e shumë klubeve në Kosovë. Sulmuesi i rrezikshëm të mërkurën për "Epokën e re" ka

thënë se nuk ka mundur t'i thoshtë jo në janar ofertës së Besës, sepse ky klub është me traditë të madhe në futbollin e Kosovës. "Kam pasur disa oferta, por zgjidhja më e mirë ishte Besa. Falënderoj ekipet që më kanë kërkuar në janar, por e kisha të domosdoshme ta zgjidhja Besën për faktin se është ndër klubet me traditën më të madhe në Kosovë", ka thënë Salihu, i cili ka treguar edhe më pas edhe për pritjen që i është bërë, ndërsa lavdëron disa nga lojtarët me përvojë, por edhe ata të rinjtë që pritet në të ardhmen

të jenë bartës të lojës së Besës. "Të gjithë në klubin e Besës më kanë pritur mirë dhe kjo dëshmon se është një klub për çdo respekt. Atmosfera është e mirë në skuadër dhe shpresojmë ta japim më të mirën, pasi kemi një skuadër cilësore që ka futbollistë me emër në futbollin e Kosovës, por edhe lojtarë të rinj që janë shumë të talentuar", ka shtuar ai. Duke folur për ambiciet e Besës në këtë edicion garash, Salihu ka thënë se mbijetesa nuk do të diskutohet. "Jemi në Shqipëri, duke u përgatitur maksimalisht



për sezonin pranveror, i cili do të jetë i vështirë për të gjitha skuadrat. Me punën që jemi duke bërë dhe me potencialin që kemi brenda skuadrës jam i bindur se mbijetesa nuk do të diskutohet, ani pse nuk do të jetë e lehtë nëse e shikojmë nga pozita aktuale në tabelë", ka deklaruar ish-sulmuesi i Ferizajt dhe Prishtinës.

Lidhur me luftën për titull, Salihu përfshiu tri skuadra, në

mesin e tyre edhe Feronikelin që ka bërë një riorganizim. "Për titullin i shoh favoritë kryesorë Llapin dhe Prishtinën, pa e anashkaluar Feronikelin". Sezioni vjeshtor ishte shumë i dobët për skuadrën e Besës, që dëshmon edhe pozita e dhjetë në renditjen tabelore me vetëm 13 pikë të grumbulluara, 12 pikë më pak se Vëllaznimi që zë pozitën e nëntë në tabelën e Superligës.

Orari i garave të Albin Tahirit në LOD 'Pyongyang 2018'

PRISHTINË, 7 SHKURT - Albin Tahiri është skitari që do ta përfaqësojë Kosovën në Lojërat Olimpikë Dimërore "Pyongyang2018". 28-vjeçari ka fituar normën olimpikë në pesë disiplina të skijimit alpik. Ai do të garojë në slallom, slallom të madh, super slallom të madh, lëshim të shpejtë dhe kombinim alpik. Garën e parë Albini do ta ketë më 11 shkurt në lëshim të shpejtë, derisa që nga 8 shkurti do t'i fillojë përgatitjet zyrtare. Garat e lëshimit të shpejtë fillojnë në orën 3.00 të mëngjesit me kohën tonë lokale, kurse në orën 11:00 me kohën në Korenë e Jugut. Lëshimi i shpejtë mbahet në qendrën alpike në Jeongseon, e cila ndodhet rreth 40 kilometra larg qytetit të Pyongyangut. Garën e dytë Albini do ta ketë më



13 shkurt në kombinim alpik. Gara fillon në orën 3:30 me kohën tonë lokale. Dy ditë më vonë, më 15 shkurt, Albin Tahiri do ta sfidojë veten në një ditë të veçantë për të. Ai do të garojë në super slallom të madh në ditën kur do t'i mbushë 29 vjet. Edhe kjo garë fillon nga ora 03:00 me

kohën tonë lokale. Gara e ardhshme e tij është ajo e slallomit të madh që mbahet më 18 shkurt, e cila fillon nga ora 2:15. Sfida e fundit kur do ta shohim Albinin në gara të LOD "Pyongyang 2018" do të jetë më 22 shkurt, kur do të garojë në slallom, duke filluar nga ora 2:15.

ORARI I GARAVE

11 shkurt - Lëshim i shpejtë	03:00 (koha jonë lokale)
13 shkurt - Kombinim alpik	03:30
15 shkurt - Super slallom i madh	03:00
18 shkurt - Slallom i madh	02:15
22 shkurt - Slallom	02:15

Kelmendi: Albin, shijoje në maksimum këtë përvojë

Sportistja më e mirë shqiptare, Majlinda Kelmendi, i ka uruar shumë suksese skitarit Albin Tahiri në Lojërat Olimpikë Dimërore "Pyongyang2018".

Tahiri është i vetmi sportist nga Kosova që merr pjesë në këto lojëra. "Albinin i dëshiroj shumë suksese. E di se ke shumë përgjithësi Albin. Do të jesh edhe bartës i flamurit, por shijoje në maksimum këtë përvojë që ndodh vetëm një herë në jetë. Krenohu me vendin që e përfaqëson", ka thënë Kelmendi.

Duka rizgjidhet kryetar i FShF-së

TI RANË, 7 SHKURT - Armand Duka është rizgjedhur për herë të pestë në krye të Federatës Shqiptare të Futbollit (FShF-së), pas votimit të mbajtur ditën e sotme në Asambledë e Shtatë të Përgjithshme Zgjedhore. Në

raundin e parë të votimit asnjëri nga tre kandidatët nuk mundi të merrte 2/3 e votave, Armand Duka në votimin e dytë ka siguruar mbi 50 % të votave duke siguruar edhe mandatin e tij të pestë. Armand Duka ka marrë 38

vota në raundin e dytë, ndërsa rivali i tij, Bashkim Fino, ka marrë 24 vota, ndërsa tri të tjera rezultuan të pavlefshme. Në raundin e parë Armand Duka mori 39 vota, ndërsa Bashkim Fino ka marrë 22 vota dhe katër vota u shpallën

të pavlefshme. Asnjë votë për kandidatit tjetër Shpëtim Hala. "Jam shumë i lumtur dhe i emocionuar. Jam i lumtur për mbështetjen që më keni dhënë. Nga sot fillon një gjë edhe më e vështirë", ka thënë Duka.



Formula 1 rikthehet në Holandë pas 35 vjetësh

AMSTERDAM, 7 SHKURT - Formula 1 mund të rikthehet në Holandë së shpejti. I deleguari për sigurinë e garave të FIA-s, Charlie Whiting, ka qëndruar në Holandë për t'i verifikuar kushtet dhe mundësitë për të zhvilluar një garë në këtë shtet në vitin 2020. Një perspektivë e kjo e drejtuesve të Formula 1,

që kërkojnë të zhvillojnë një garë në "vendet e ulëta" 35 vjet pas garës së fundit. Hera e fundit që është garuar në Holandë është viti 1985, në pistën e Zandvoort. Por, duke parë popullaritetin që ka piloti i ri Mx Verstappen po shihet mundësia që të zhvillohet një garë në këtë vend. Pista e

Zandvoort është ende në gjendje të mirë dhe zhvillohen gara të kategorive të ndryshme, por në listë është edhe pista e Assenit, ku zhvillohen garat e Moto GP. Madje Whiting ka vizituar pikërisht pistën e Assenit, që e shihet si më të përshtatshme për një garë të Formula 1, duke qenë se

infrastruktura është më moderne dhe ofron më shumë siguri për pilotët. Pista e Assenit është 4,5 kilometra e gjatë dhe mund t'i mirëpresë deri në 110 mijë spektatorë dhe me disa modifikime të vogla mund t'i mirëpresë pa probleme edhe garat e Formula 1.



Ndahet parcela për ndërtimin e stadiumit sintetik në Gjakovë

GJAKOVË, 7 SHKURT - Kuvendi i Komunës së Gjakovës të mërkurën në seancën e jashtëzakonshme ka votuar me shumicë votash propozim-vendimin e kryetarit të komunës, Ardian Gjini, për ndarjen e parcelës për ndërtimin e fushës sintetike të futbollit. Para se të hidhej në votim, ku pati edhe diskutime nga ana e këshilltarëve komunalë, kryetari Ardian Gjini ka pohuar se e vetmja arsye që kjo mbledhje është thirrur si e jashtëzakonshme ka qenë fakti se propozimi nga Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ka ardhur me vonesë dhe se me afat të shpejtë kohor, brenda dy ditëve, duhet të dërgohet ky vendim në këtë institucion. Në qartësimin e tij para këshilltarëve komunalë, kryetari Gjini ka thënë pjesa e parcelës së cekur caktohet për ndërtimin e fushës së futbollit-sintetike, sipas standardeve të FIFA-s dhe UEFA-s, e cila do të shfrytëzohet nga klubet e futbollit të Komunës së Gjakovës që garojnë në Superligën e Kosovës.



Gjithashtu, kryetari Gjini ka bërë me dije se investimi për këtë projekt është i përbashkët, që do të bëhet në bazë të memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet tri institucioneve, si Federata e Futbollit e Kosovës, e cila do të investojë 120 000 euro, Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport (MKRS) që do ta investojë shumën prej 100 000 eurosh, si dhe Komuna e Gjakovës që për këtë dedikim do të ndajë 30 000 euro. Kjo pjesë e parcelës së kësaj

zone kadastrale ka sipërfaqe të përgjithshme prej 81132.0 metrash katrorë dhe me një vendim të Kuvendit të Komunës së Gjakovës të vitit 2014 është shpallur zonë e interesit publik, ndërsa një pjesë e saj është caktuar për ndërtimin e terreneve të tenisit. Me këtë vendim këtyre kompleksit rekreativ i shtohet edhe fusha sintetike e futbollit e cila do të ndikojë në shtimin e aktiviteteve rekreative sportive në këtë pjesë të qytetit.

Ditë tersi për Warriorsin, Clevelandin dhe Bostonin

BOSTON, 7 SHKURT - Ndeshjet e radhës në NBA kanë sjellë rezultate surprizë, me humbjen e ekipeve të Golden States dhe Clevelandit, që duket se nuk po kalojnë një moment të mirë. Cavaliersi vijon momentin e krizës, që u mund 116-98 nga Orlando, ndeshje e komanduar nga skuadra vendëse. Clevelandi e nisi mirë takimin, por në periudën e fundit erdhi përmbysja e skuadrës vendëse, ku u dallua Simmons me 34 pikë, ndërsa 25 pikët e 10 reboundet e LeBron Jamesit mbetën për statistikë. Zhgënjën edhe Golden State, që u mund 125-105 nga Oklahoma, ndeshje e dominuar nga Thunderi, me Paul Georgen që realizoi 38 pikë, ndërsa Duranti 34, duke bërë diferencën në parket. Për Warriorsin u dallua Duranti me 33 pikë, por që mbetën për statistikë. Fiton skuadra e Houstonit, që mundi 123-113 Brooklyn dhe kërkon ta marrë kreun në Perëndim, ndeshje e



dominuar nga miqtë, ku u dallua Hardeni me 36 pikë e Pauli me 25, raporton "Telesport". Surprizat kanë vijuar edhe me humbjen e Bostonit, deri-diku e pritshme, duke qenë se luajti në fushën e Torontos, që fitoi 111-91. Skuadra kanadeze dominoi në ndeshje, duke e thelluar diferencën me kalimin e minutave, me Lowryn që realizoi 23 pikë, më i mirë në fushë për Toronton.

REZULTATET		
Orlando - Cleveland	116-98	
Atlanta - Memphis	108-82	
Brooklyn - Houston	113-123	
New York - Milwaukee	89-103	
Toronto - Boston	111-91	
Philadelphia - Washington	115-102	
Golden State - Oklahoma	105-125	
Lakers - Phoenix	112-93	

SHKURT

Lugu i Baranit angazhon ish-yjet e Besës në shtab teknik

Skuadra e Ligës së Dytë, Lugu i Baranit, ka angazhuar dy ish-yjet e Besës në krye të shtabit teknik. Fjala është për ish-mesfushorin Fisnik Gashi, i cili është edhe trajner me licencë të UEFA-s dhe ish-portieri legjendar Ekrem Veseli. Kjo skuadër ditë më parë arriti marrëveshje edhe me mesfushorin Mensur Duraku.

Messi befason Coutinhon

Transferimi nga Liverpooli në Barcelonë për një shumë rekord në vlerë 160 milionë euro gjatë janarit ia ka mundësuar Philippe Coutinho t'iu bashkohet superjeteve më të mëdha në "Camp Nou". "Është një ndjesi e jashtëzakonshme kur shikon përreth zhveshtores dhe sheh Andresin, Leon, Luis [Suarezin] dhe Sergio Busquetsin dhe të tjerët", ka thënë Coutinho për "Sky Sport". "Ata janë lojtarë të cilët i shihja në TV apo me të cilët luaja në PlayStation, por tani e ndaj zhveshtoren me ta, gjë që është e jashtëzakonshme për mua", ka shtuar braziliani. Ai ka theksuar se Messi e ka mirëpritur ngrohtë si gjithë të tjerët. "Si gjithë të tjerët edhe unë gjithmonë kam menduar se Messi është lojtari më i mirë në botë dhe tani që jam këtu me të, ndihem i nderuar. Është përvojë fantastike ta shoh duke stërvitur dhe luajtur. Mënyra se si e transformon ndeshjen ai është e pabesueshme", ka theksuar Coutinho. "Ai është personi më i vërtetë i qetë. Si gjithë të tjerët, më mirëpriti ngrohtë. U trondita sepse e pashë që është person real", ka shtuar Coutinho.

Vazhdon interesimi i Milanit për Belottin

AC Milan vazhdon të jetë i interesuar për transferimin e sulmuesit Andrea Belotti nga Torino. Lajmin e ka konfirmuar drejtori sportiv i Milanit, Massimiliano Mirabelli. "Të gjithë e dinë që ne provuan ta sjellim të Milani, por kjo nuk u bë shkaku i shumë arsyeve. Ai mbetet lojtar shumë i mirë, një tifoz i Milanit dhe kush e di. Ndodhshja një ditë ai do ta veshë fanellën që e kishte ëndërr që kur ishte i vogël", ka thënë Mirabelli.

Evra, lojtar i ri i West Hamit

Patrice Evra edhe zyrtarisht është lojtar i ri i skuadrës së West Ham Unitedit. 36-vjeçari francez do të jetë pjesë e skuadrës angleze deri në qershor të këtij viti, kurse ai në këtë klub u transferua si lojtar i lirë. "Sky Sports News" raporton se interesim për ish-lojtarin e Monacos, Manchester Unitedit, Juventusit dhe Marseillet kishte shfaqur edhe Evertoni, por ai preferoi transferim në West Ham.

Lineker: Messi vlen sa tre lojtarë në fushë

Gary Lineker ka thënë se Lionel Messi është lojtari më i mirë i të gjitha kohëve. Lineker njihet si një tifoz i Barcelonës dhe u bë i famshëm për deklaratat kur ironizoi me Zidanën dhe Benzeman. "E dua Barcelonën. I shikoj ndeshjet e tyre: jam tifoz i Barcelonës, së bashku me katër fëmijët e mi. Barcelona ka qenë më e mirë që kur luani Ronaldinho, Xavi, [Andres] Iniesta dhe tani edhe me Messin. Argentinasi është nga një botë tjetër. Ai bën katër, pesë gjëra në një ndeshje, që unë nuk kam arritur t'i bëj në të gjithë karrierën. Ai bën gjëra të jashtëzakonshme, është më i mirë në histori" ka thënë Lineker për "Mundo Deportivo". "Barcelona luan me 13 lojtarë, pasi e kanë Messin. Shumë thonë se Maradona është më i mirë se Messi pasi e ka fituar Kupën e Botës, por Maradona nuk e ka fituar asnjëherë Ligën e Kampionëve, ndërsa Messi e ka fituar katër herë", ka deklaruar Linekeri.



Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo
 Qeveria – Vlada – Government
 Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar të Kosovës (SHSKUK)
 Univerziteti i Klinikë Sluzbe Kosova (UBSKK)
 Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
 Qendra Klinikë Universitare e Kosovës – Universiteti i Klinikë Centar Kosova – University
 Clinical Center of Kosovo
Sektori i Personelit



Bazuarë nën 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 13 paragrafi 1 dhe 3 e Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitar të Kosovës, (SHSKUK); mbështetur në nenin 62 të Ligjit për Shëndetësi Nr.04/L-125; nenit 13 paragrafi 1 e Statutit të Qendrës Klinikë Universitare të Kosovës, neni 5 paragrafi 1 dhe 2 e Rregullores Nr.1003/2016 mbi marrëdhënien e punës; Kërkesave të datës 24.01.2018 dhe 31.01.2018, U.D. Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, shpallë:

KONKURS

Nr	Titulli i punës	Departamenti/Sektori	Nr.pozitav të lira pune
1	Zyrtar i teknologjisë informative	Administrata e QKUK	1
2	Inkasant	Sektori i Buxhetit dhe Financave	2
3	Servuese e ushqimit	Sektori i Ushqimit dhe Servimit	1

I. Titulli i punës: Zyrtar Administrativ dhe i Teknologjisë Informative (1 pozitë në QKUK)
Orari i punës: 40 orë në javë (orar të plotë)
Koeficienti i pagës: (7.2)
Nëpunësi mbikëqyrës: Përgjegjës të Teknologjisë Informative të QKUK
Kohëzgjatja: Kontrata me afat të pa/caktuar
Nr.i Referencës: QKUK - 06/2018-2/4

Detvatr dhe përgjegjësitë:

- Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planin e punës dhe afatet me udhëheqësin dhe stafin tjetër profesional për planifikimin e pajisjeve të teknologjisë informative të QKUK-së;
- Kujdeset për montimin e pajisjeve të teknologjisë informative përfshirë kompjuter, printer, skaner dhe pajisje tjera;
- Ndihmon personelin e institucionit në përdorimin e pajisjeve të teknologjisë informative, aplikacioneve dhe bazave të të dhënave dhe kryen aktivitete tjera me qëllim për t'i ofruar gjithë personelit qasje të lehtë në sistemin e teknologjisë informative;
- Instalon kompjuterët me sisteme operative Windows, Office dhe softuer tjetër sipas nevojës duke u kujdesur për ruajtjen e shënimeve;
- Evidenton defektet në pajisje e sipas nevojës dhe në konsultim me mbikëqyrësin i mirëmban rregullisht ato;
- Ndihmon Shefin e Sektorit të Shërbimeve Teknike në kryerjen e punëve tjera në kuadër të këtij sektori,
- Bashkëpunon ngushtë me shefin e Sektorit të Shërbimeve Teknike në realizimin e punëve të përditshme në kuadër të këtij sektori,
- Kryen edhe detyra tjera të caktuara nga Mbikëqyrësi në harmoni me legjislacionin në fuqi.

Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale, bazuar në specifikat e institucionit :

- Shkolla e mesme (drejtimi jo mjekësor)
- Përvojë pune së paku dy (2) vite në fushën e teknologjisë informative;
- Certifikim dhe dëshmi të tjera për specializim në IT-teknologji informative dhe trajnime të ngjashme;
- Të ketë shkathtësi për të krijuar marrëdhënie të mira ndërpersonale;
- Aftësi për të ndihmuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët;
- Të ketë shkathtësi të krijimit të sistemit të raportimit,
- Njohja e gjuhëve zyrtare në përdorim (shqip, anglisht dhe serbo-kroatisht)
- Certifikata e Lindjes – fotokopje dhe
- Letërnjoftimi - fotokopje.

II. Titulli i punës: Inkasant (2 pozita në QKUK)
Orari i punës: 40 orë në javë (orar të plotë)
Koeficienti i pagës: (4.8)
Nëpunësi mbikëqyrës: Zyrtari për të hyra vetanake
Sektori : Buxheti dhe Financa
Kohëzgjatja: Kontrata me afat të pa/caktuar
Nr.i Referencës: QKUK 06/2018-2/4

Detvatr dhe përgjegjësitë:

- Bën pranimin e bllokave të participimit nga Arkatari Kryesor;
- Mban evidencë për bllokot e participimit;
- Bën regjistrimin e arkës ditore sipas specifikacioneve;
- Bën dorëzimin e participimit ditor te Arkatari Kryesor;
- Bën evidentimin dhe lëshuarjen e faturave për pacientet e siguruar;
- Siguron ndarjen dhe ruajtjen e kopjeve përkatëse nga blloku i participimit;
- Siguron kryerjen e participimit në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohë nga mbikëqyrësi.

Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale, bazuar në specifikat e institucionit :

- Shkolla e mesme jo mjekësore;
- Njohuri lidhur me procedurat standarde administrative/teknike në një fushë të njohur teknike ose administrative;
- Aftësi për të punuar me vet-iniciativë në kuadër të planeve dhe procedurave të përcaktuara;
- Aftësi koordinimi dhe mbikëqyrje të punës së personelit në nivelin administrativ dhe teknik;
- Shkathtësi të mira të komunikimit, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, dhe në udhëzime dhe përcjellje informata e të tjerët
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel)
- Certifikata e Lindjes – fotokopje dhe
- Letërnjoftimi.

III. Titulli i punës: Servuese e ushqimit (1 pozitë në QKUK)
Orari i punës: 40 orë në javë (orar të plotë)
Koeficienti i pagës: (4.0)
Nëpunësi mbikëqyrës: Përgjegjës të Njësisë
Sektori : Ushqimit dhe Servimit
Kohëzgjatja: Kontrata me afat të pa/caktuar
Nr.i Referencës: QKUK 06/2018-2/4

Detvatr dhe përgjegjësitë:

- Bën pranimin e ushqimit të gatshëm dhe ushqimit të thatë nga kuzhina qendrore;
- Bën hartjen e ushqimit deri në vendin e caktuar-kuzhina interne,dhoma të pacientëve;
- Është e obliguar që pacientëve t'i ndajë sasinë/llojin e ushqimit të caktuar sipas kërkesës së Klinikave;
- Bën shërbimin e ushqimit për çdo pacient;
- Bën mbledhjen e enëve dhe larjen e enëve;
- Bën pastrimin e enëve, i rendit deri në përdorimin e ardhshëm;
- Kujdeset për hixhenen e përditshme të inventarit dhe pajisjeve tjera dhe të lokalit-kuzhinës;
- Pranon inventarin dhe ter garniturën e ushqimit dhe me të ngarkohet materialisht;
- Është përgjegjës për ruajtjen e inventarit dhe pajisjeve tjera.

Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale, bazuar në specifikat e institucionit :

- Diploma - Shkolla e mesme jo mjekësore;
- Njohuri lidhur me procedurat teknike të servimit të ushqimit;
- Certifikata e lindjes – fotokopje,
- Letërnjoftimi – fotokopje,
- E dëshirueshme përvoja e punës;

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Konkursi është i shpallur 15 ditë nga dita e shpalljes në njërin nga gazetat ditore

Paraqitja e kërkesave : Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Qendrën Klinikë Universitare të Kosovës në Prishtinë, Zyra e Sektorit të Personelit në Klinikën e Syve.
 Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentacioni mbi kualifikimin, dëshmi përkatëse për përvojën e punës, si dhe dëshmi tjera të kërkuara në konkursin publik.

- ✓ Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në tel : 038 500 600 25 15 (Zyra e Sektorit të Personelit), prej orës 8:00-14:00.

U.D Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Dr. Basri Sejdiu

Lume's Details
 Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 llullat, Rr. Bajram Kelmendi



Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo
 Qeveria – Vlada – Government
 Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar të Kosovës (SHSKUK)
 Universitetske Bolničke i Kliniçe Službe Kosova (UBKSK)
 Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
 Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinički Centar Kosova –
 University Clinical Center of Kosovo
Sektor i Personelit



Prema članu 8 Zakona, tačka 1 i 2 o radu br. 03/1.-212, član 4, Administrativno Uputstvo (MRSZ) br. 07/2017 o Regulisanje Procedura Konkursa na Javnom Sektoru, člana 13. tačka 1 i 3, Statuta Bolničke Službe i Univerzitetskog Kliničkog Centra Kosova (UBKSK), kao i član 62, Zakona br. 04/L-125, o Zdravstvo, Član 13, tačka 1 Statuta Univerzitetski Klinički Centar Kosova, član 5 tačka 1 i 2, Uredbe o radnim odnosima br. 1003 datum 21.07.2016, Zahtevi od 24.01.2018 i 31.01.2018, V. D. Generalnog Direktora UBKSK, objavljuje

KONKURS

Institucije: **Univerzitetski Bolničke i Kliniçe Službe Kosova. (UBKSK)**

Br	Naziv rada	Odsjek / Sektor	Br. Prazni radni mesta
1	Službenik za informacione tehnologije	UPCK Administracija	1
2	Inkasant	Budžet i Finansijski Sektor	2
3	Servirke za Hrane	Služba za hranu i serviranje hrane	1

I. Radno mesto: Administrativni službenik i informacione tehnologije
 (1 pozicija u UKCK)
 Radno vreme: 40 sati nedeljno (puno radno vreme)
 Koefficient zarade: (7.2)
 Nadzorni službenik: Odgovorna Informaciona Tehnologija UKCK
 Trajanje: Ugovor o vremenskom neograničenju
 Br. Referentni UKCK - 06/2018-2/4

Dužnosti i odgovornosti:

- Razvija i upravlja saglasnost za plan rada i uslovima liderstva i ostalih stručnih kadrova opreme informacione tehnologije UKCK i planiranja;
- Raspored za montiranje kompjutera, aplikacije i baze podataka za i obavlja druge poslove kako bi ponudili svo osoblje lak pristup sistema informacionih tehnologija;
- Instalira Kompjutera sa Vindovsom i operativnim sistemima, Office i drugi softver po potrebi vodi računa o vođenju evidencije;
- Identifikuje nedostatek u opremi i ukoliko je potrebno, u konsultaciji sa supervizorom ih redovno održavaju;
- Saraduje blisko sa šefom Sektora tehničkih službi u sprovođenju dnevnog rada u ovom sektoru,
- Obavlja i druge poslove koje mu poveri šefu

Kvalifikacije, iskustvo, veštine i lične karakteristike, na osnovu specifičnosti institucije:

- Srednja škola (ne medicinski smer)
- Iskustvo najmanje dva (2) godine u oblasti informacionih tehnologija;
- Sertifikaciju i druge dokaze o specijalizaciji u IT informacionoj tehnologiji i sličnim obukama;
- posedovati veštine za uspostavljanje dobrih međuljudskih odnosa;
- Sposobnost pomoći i saradnje sa drugima;
- Imaju sposobnost da osigurati sistem izveštavanja,
- Poznavanje službenih jezika (albanskom, engleskom i srpsko-hrvatski)
- Izvod rođeni – fotokopije,
- Licna karat – fotokopije,

II. Radno mesto: Inkasant (2 mesta u UKCK)
 Radno vreme: 40 sati nedeljno (puno radno vreme)
 Koefficient zarade: (4.8)
 Nadzorni službenik: Službenik prihoda za sopstvene izvore
 Sektor: Budžet i finansije
 Trajanje: Ugovor o vremenskom neograničenju
 Referentni broj: UKCK - 06/2018-2/4

Dužnosti i odgovornosti:

- Prijem blokova za učešće glavnog blagajnika;
- Održava evidenciju o participaciji blokova;
- Registruje dnevnu kasu prema specifikacijama;
- Predaji dnevnog učešća glavnog blagajnika;
- Identifikuje i izdaje fakture za osigurane pacijente;
- Osigurati razmenu i čuvanje kopije relevantnih učešća bloka;
- Obezbeduje performanse učešće u skladu sa važećim zakonom;
- Obavlja i druge poslove u skladu sa zakonima i propisima koje se može zahtevati u razumnom roku nakon vremena od strane šefa.

Kvalifikacije, iskustvo, veštine i lične karakteristike, na osnovu specifičnosti institucije:

- Srednja škola (ne medicinski smer)
- Znanje u vezi sa standardnim administrativnih / tehničkih postupaka u priznate tehničke ili administrativne oblasti;
- Sposobnost da radi na sopstvenu inicijativu u okviru definisanih planova i procedura;
- Sposobnost koordinacije i nadgledanja rada osoblja na administrativnom i tehničkom nivou;
- Dobre komunikacione veštine, uključujući sposobnost da se tumači informacije, kao i smernice i prenos informacije drugima;
- Veštine kompjutera u aplikacionim programima (Vord, Exel)
- Izvod rođeni – fotokopije,
- Licna karat – fotokopije,

III. Naziv posla: Servirka za hranu (1 pozicija u UKCK)
 Radno vreme: 40 sati nedeljno (puno radno vreme)
 Koefficient zarade: (4.0)
 Nadzorni službenik: Službenik jedinice
 Sektor: Hrana i Služba
 Trajanje: Ugovor o vremenskom neograničenju
 Referentni broj: UKCK - 06/2018-2/4

Dužnosti i odgovornosti:

- Prijem hrane spremna i suve hrane iz Centralne Kuhinje;
- Čini nosi hranu na mesto određene unutrašnje-kuhinje, sobe za pacijente;
- On je obavezan da izdvoji pacijente u iznosu / vrste hrane koju su klinikama potražnje;
- Pruža usluge hrane za svakog pacijenta;
- Sakuplja posude i pranje posude;
- Čisti posude, sortira ih za buduću upotrebu;
- Zagarantuje dnevne inventar i drugu opremu i posude;
- Prima inventar i postavlja set hrane i materijalno naplaćuje;
- Odgovoran je za skladištenje inventara i druge opreme.

Kvalifikacije, iskustvo, veštine i lične karakteristike, na osnovu specifičnosti institucije:
 • Srednja škola (ne medicinski smer)
 • Poznavanje tehničkih procedura za servisiranje hrane;
 • Izvod iz matične knjige rođenih - fotokopija,
 • Poželjno radno iskustvo;
 * Licna karat – fotokopije,

Uslovi za učešće u zapošljavanju: Svi građani Republike Kosova sa punom kapacitetom da deluju, imaju adekvatno obrazovanje i imaju profesionalnu sposobnost da obavljaju svoje dužnosti imaju pravo da se prijave.

Konkurs se objavljuje 15 dana od dana objavljivanja u jednom dnevnom listu.

Podnošenje prijave: Prijave su primljene i dostavljene Univerzitetskom kliničkom Centru Kosova u Prištini, Kancelarija Kadrovske Službe u Očnoj klinici. Aplikaciji je priložena dokumentacijom o kvalifikaciji, relevantnim dokazima radnog iskustva, kao i drugim dokazima koji se traže na javnom konkursu.

Zahtjevi poslani nakon poslednjeg datuma neće biti prihvaćeni. Nepotpuni zahtevi će biti odbijeni.

Za detaljne informacije kontaktirajte tel: 038 500 600 25 15 (Služba za osoblje) od 8:00 do 14:00 časova.

V.D Generalnog Direktora
UBKSK

Dr. Basri Sejdiu

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Florent Hajrizi shpallë të pavlefshme Diplomën e Masterit të Kolegjit Iliria Prishtinë.
- Vesa Spahiu nga Prishtina, shpallë të pavlefshme dëftesën e shkollës Fillore "Elena Gjika" Prishtinë.
- Leomir Xhemaj shpall te pavlefshme dëftesat e vitit X,XI,XII dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.
- Isen Nasufaj shpall te pavlefshme dëftesat e shf " Dëshmorët e Zhurit " Zhur.
- Enis Pulaj shpall te pavlefshme dëftesat, diplomën e certifikatën shmlt "11 Marsi" Prizren.
- O.S. "Vita-Dent" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit dhe numrin fiscal 600231071.
- N.T.T. "Klysyra -97" shpall të pavlefshme certifikatën e regjistrimit dhe nr. fiskal 71109359 dhe 601182158, lëshuar në vitin 2014
- Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxeheje qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958
- Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësorjëm me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.
- Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknikë në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783
- Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ar, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

Oferte Për Shitjen e Patundshmërisë

Vojkan (Nukolla) Radivojeviq nga Prizreni Rr. Rifat Ukimeri nr 63 është bashkëpronar ne pjesën prej 17810 M2 e pjesës ideale te patundshmërisë te njësisë kadastrale nr: 71813023-00365/1 te vendi i quajtur - Ispod Sela ZK Dushanovë . Nga pjesa e vete ideale oferton për shitje sipërfaqen prej 3562 M2 te patundshmërisë me te dhënat si me lart, ne shumën: 75.000.00. E me shkronja (shtatëdhjetë e pesëmijë euro). Prizren 26.01.2018



FTESE PER OFERTE

Byroja Kosovare e Sigurimit fton të gjitha kompanitë e interesuara që të ofertojnë për tenderin me titull:

“Furnizim me material shpenzues “Byfe” për nevojat e Byrosë Kosovare të Sigurimit“

Kushtet për ofertim:

- Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrimin e biznesit dhe TVSH-në
- Eksperienca e ofertuesit me pune të ngjashme, se paku në dy vitet e fundit
- Garancioni për shërbimin e ofruar
- Dhe kushtet e tjera të përcaktuar në dosjen e tenderit

Të interesuarit duhet të dorëzojnë ofertën në zarfë të mbyllur në zyrën e Byrosë Kosovare të Sigurimit në adresën Rr. Lidhja e Pejes, pn. (magjistralja Prishtinë – Fushë Kosovë).

Data e dorëzimit të ofertës është: 12.02.2018 ora 13-14:00.

Dosjen e tenderit mund ta kërkonti përmes email-it si në vijim: bks@bks-ks.org

Ofertat e dorëzuara pas kësaj kohe nuk merren parasysh.



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Datë:08.02.2018
Junik

Në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nën titullin 11, paragrafi 1, nën 18 paragrafi 1 dhe 3, dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit mbi Shërbim Civil, nën 3 paragrafi 1 dhe 2. Kryetari i Komunës Shpallë: Kështu.

K O N K U R S

Institucioni:	Komuna e Junikut
Drejtorja:	Drejtorja për Buxhet dhe Financa
Titulli i vendit të punës:	Zyrtar për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme (1 nËpunës)
Kategoria funksionale/Grada:	Koeficienti-7
Numri i referencës:	RN00002702
Lloji i pozitës:	Karrierës

Detyrat dhe përgjegjësit:

1. Përcjell dhe përcakton ndryshimet në terren (toka), që kanë ndikim në shërbimet e të dhënave dhe kadastrin e tokave.
2. Transferon ndryshimet e përcaktuara në masën kadastrin në elaboret, plane dhe programe.
3. Përcakton, riprodhon dhe transferon ndryshimet, duke përfshirë saktësisht me metoda të vendosura normal dhe rregullat për masën dhe kadastrin e tokave.
4. Përpilon regjistrin e fletëparaqitjeve sipas kërkesës së palëve (ndërrimet e kultiveve, bashkimin e ngjashme, lirinë dhe gjendjen faktike të tokës).
5. Eshë përgjegjës për mirëmbajtjen e mjekëve dhe aparaturave matëse si gjatë punës në terren ashtu edhe në zyrë.
6. Bënë shqimin e tokave me matje dhe pa matje sipas kërkesës të paraqitura duke bërë harmonizimin e ndërrimeve të paraqitura në terren me planin përbërës, identifikimin e parcelave, kontrollimin dhe plotësimin e hartës gjëdolet, fotografimin me metoda gjëdolet, hartimin e akteve-vendimtarë të matjeve, fletëparaqitjeve dhe komunikimit të rezultateve të tyre.
7. Sipas nevojës bënë fotografimin e objekteve të ndryshme si dhe të kufijve kur këto palët me marrëveshje e kërkojnë.
8. Për punën e tij-saj i përgjigjet dhe i raporton shërbimit të sektorit.
9. Kryon edhe punë tjera që kanë të bëjnë me të tashmin në pronë.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të mosbë më shumë se një aplikim për të cilin kanë zotësi për të vepruar, kanë përvojatim e nevojshme shkollore dhe aftësi fizike që kërkohe për pozitën përcaktuar.

Procedurat e konkurimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Shkallimi i kërkuar: Ekonomik, Administrim Biznesi, Juridik, Fdhim, Teknologji Informative, Administratë publike.

Aftësi i përvojës dhe atributet tjera që kërkohen: të paktën dy (2) vite përvojë punë: tjuhorit profesional; të kështu aftësi komunikuese, napsociale dhe bindëse në menaxhimin e punëve, shkallësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Internet).

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve: Aplikacionet marrin dhe dorëzohen në ndërrimin e Komandës pranë: Zyrës Prëse. Konkursi mbyetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit nga data: **08-02-2018 deri 22-02-2018**.

Aplikacioni i bashkëngjitet kopja e dokumentacionit mbi kualifikimin: Ekstraktin e lëndjes, përvojën e punës, Certifikatën të trajnimeve nëse ka, Letërnjoftimin i Republikës së Kosovës, Certifikatën Shëndetësore dhe dokumentacione tjera për këtë pozitë. Kandidantët të cilët përzgjedhen në listën e ngjarjeve për intervistë rëndësishme me shikim nën në telefon në afat ligjor, kandidatët janë të obliguar që të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimin, trajnimet dhe të gjitha ato dokumente të cilat janë dorëzuar në aplikacion, dhe të cilat dohet të verifikohen nga Komisioni i Intervistës.

Shërbimi Civil i Kosovës o shërbim të gjithë burimeve të Kosovës dhe mirëpreti aplikantët nga fuqitë e të gjitha komuniteteve të Kosovës.

Udhëheqësja e personelit
Venera Shala





Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës



Drejtoria Për Arsim dhe Edukim

Nr: 11/74

Më: 07.02.2018

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), Neni 5 pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Drejtoria për Arsim dhe Edukim shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendit të punës

Viti shkollor 2018

Nr.	Niveli, Shkolla	Pozita	Vendi i lirë/zëvendësim	Numri i pozitive	orë
1	SHFMU" Petro Nini Luarasi" në Llapqevë	Mësimdhënës/e i/e programit fillor	Vendi i lirë	1	20
2	SHFMU" Fehmi Agani" në Turjakë	Mësimdhënës/e i/c lëndës së edukatës fizike dhe sportive	Zëvendësim me kohë të caktuar deri sa të kthehet punëtori në vendin e punë	1	20
3	SHFMU" Ibrahim Mazreku" në Malishevë	Mësimdhënës/e i/c lëndës së gjuhës angleze	Zëvendësim me kohë të caktuar deri sa të kthehet punëtori në vendin e punë	1	20

I. Aplikacionit i bashëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit
- Rezumeja personale (CV)
- Dokumenti personal (letërnjoftimi ose pasaporta)
- Diploma e kualifikimit (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuar të noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime
- Dëshmi të përvojës në institucionet arsimore (nëse ka)

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit paraimunivertzitar.

Kriteret e kualifikimit:

- Për mësimdhënës klasor :Fakulteti i Edukimit -Programi Fillor, Fakulteti i Mësuesisë dhe
- Për mësimdhënës të lëndës së kulturës fizike dhe sportive: Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sporteve.
- Fakulteti i Edukimit -Programi i gjuhës dhe Letërsisë angleze, Fakulteti i Filologjisë dega e gjuhës dhe letërsisë angleze, ashtu siç planifikohet me UA të MASHT-it Nr. 05/2015 dhe UA 06/2015

Vetëm në mungesë të kandidatëve nga sqarimi i lartcekur, do të shqyrtohen dhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim më të përafërt.

III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuar dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuar me dokumente(jo ata që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi)

SQARIM: Kandidatët mund të konkurrojnë në më shumë shkolla, por me dokumente të veçanta.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të jenë të nostifikuar diplomat nga MASHT.

Për intervistë do të ftohën ata kandidat të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të cekura.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohën për intervistë dhe orari i intervistave publikohet në web-faqen e Komunës së Malishevës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më: **07.02.2018 deri më datën:21.02.2018**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes protokollit, përkatësisht përmes zyrës së prijës së palëve, në objektin e ri të Komunës së Malishevës.

Drejtori i DKA-së

Blerim Taçi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Zyra e Kryetarit
Nr. ~~14-654~~ 2018
Kline me 07.02.2018

KONKURS PËR ANGAZHIM AFATSHKURTER
(marrveshje për shërbime të veçanta)

1. (Nje) Keshilltar për media në Zyre të Kryetarit,

Zyra e Kryetarit

konform nenit 12 paragrafi 4 të ligjit nr. 03/L-149 për shërbimin civil të Kosovës
(marrëveshje për shërbime të veçanta)

Projekti :Komuna e Klinës: ofrimi i shërbimeve dhe i keshillave për Kryetarin e Komunës në Zyre të Kryetarit në Klinë.

Datë: 07.02.2018

QELIMI I PROJEKTIT;

- Duke u bazuar në nevojën urgjente në Komunën e Klinae, lidhur me keshillat për media në të gjitha sferat për nevojat e Kryetarit të Komunës në atë ekonomike financiare dhe në aspektin e gjendjes aktuale në të cilët gjendet Komuna duhet të angazhohet 1(nje) Keshilltar për media në zyrë të Kryetarit në një angazhim afatshkurter prej 6 muaj me pagën 400 euro bruto në muaj për të ofruar kërkesat dhe objektivat në zyrë të Kryetarit.

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT;

- Me anë të këtij projekti Komuna synon që Kryetari i Komunës të merr keshilla adekuate në sferën e emdiave dhe kompetencat që ka Kryetari.

PËRSHKRIMI I DETYRAVE :

- Ofron keshilla në objektivat në media,
- Jep keshilla në qeshjet juridike
- Komunikon me Kryetarin dhe jep keshilla mbrenda institucionit dhe jashtë tij për shkëmbim të informatave në fushën e interesit të përbashket,
- Ofron përkatësi në fushën specifike profesionale .

KUALIFIKIMI;

- Diplom univertzitare-drejtimi Skenca politike
- Përvojë në sferën e keshilltarit
- Të ket aftsi kompjuterike komunikative .

Kualifikimet:

Të drejt konkurrimi kanë të gjithë personat e interesuar

AFATI I KONKURIMIT :

Afati i konkurimit është 3 ditë nga dita e shpalljes së konkursit

Personi kontaktues : Zyra e personelit në Komunën e Klinae
Udheheqesi i personelit Xhavit Dauti
Email : xhavit.dauti@rks-gov.net
Tel:044-887-659 dhe centriks 43722

Vini re : vetëm kandidatet e përzgjedhur do të kontaktohen për intervistim



*Gjithmon me merr malli për verën tërë
Urime dita e pavaresisë!*

*Urime përjetori i 10 Kosovë
Shpresoj që 10 gjatë të ardhshme
konfliktet e mi kanë në qorë krahar
... e kështu ka në sot*

*Një krah famiçles tërë që jetojnë
sotë, ky përjetori i dëshkohet
shumë atyre që kanë qendur
kemi arrit në këtë pikë si vend!*

*Sot 10 vjet kjo ditë ka qorë ardhur për ne
Që prej asnjë ditë ure besoj që puna në
gjithmonë kërkohet! Urime Kosova jone!
Zemra pushon vet këtu!*


*Një ditë ka shumë punë që me arrit
ka dëshet për e di që këtu ka gjere që
shumë dhe kanë besim në ardhmëri e*

*Shpresoj ma turizim për Kosovën
e që vitet e ardhshme tjere ma suksesshme
Gjezuar përjetori i pavaresisë!*

RC
cola

100 mesazhe
Kosovës

**MADE IN
KOSOVA**



Revistën për kulturë, gjuhë, media, "Akademia", mund ta gjeni në redaksinë e gazetës "Epoka e re", në Sheshin "Edit Durham", 100 metra larg "Grand Hotel"-it. Për informata të tjera mund të thërrisni në këtë numër të telefonit: +377 44 127 434.